



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. regjistri 14 (JR)
Datë 07.09.2018

Nr. 9 i vendimit
Datë 18.04.2019

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Natasha Mulaj	Kryesuese
Rezarta Schuetz	Relatore
Ina Rama	Anëtare
Luan Daci	Anëtar
Sokol Çomo	Anëtar

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 18.04.2019, ora 09:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Mia LHE Roessingh-Bakels, me Sekretare Gjyqësore Adelajda Hiska, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit që i përket:

ANKUES: Komisioneri Publik Florian Ballhysa.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 47, datë 25.07.2018, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Astrit Faqolli.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë publike, me praninë e palëve, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), dëgjoji Komisionerin

Publik, i cili përfundimisht bazuar në nenin 66, germa “b” dhe nenin 61, pika 3, të ligjit nr. 84/2016 kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 47, datë 25.07.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) për subjektin e rivlerësimit z. Astrit Faqolli (në vijim “subjekti i rivlerësimit”) dhe shkarkimin e tij nga detyra, dëgjoi subjektin e rivlerësimit, i cili kërkoi përfundimisht lënien në fuqi të vendimit objekt shqyrtimi, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Rezarta Schuetz, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Astrit Faqolli, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, në zbatim të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 276 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, iu nënshtua procesit të rivlerësimit me përparësi, për shkak të kandidimit të tij për anëtar të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
2. Subjekti i rivlerësimit është bërë subjekt deklarues në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”) në vitin 2003, me numër indeksi 1338. Në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” (në vijim “ligji nr. 9049/2003”) i ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” (në vijim “ligji nr. 9367/2005”) i ndryshuar, subjekti ka dorëzuar ndër vite deklaratat e pasurisë, përfshirë deklaratën e pasurisë (*vetting*) 2017 (brenda afatit ligjor).
3. ILDKPKI-ja, bazuar në nenin 33 të ligjit nr. 84/2016¹, i ka dërguar Komisionit raportin përfundimtar, në të cilin konkludon se:
 - i. deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
 - ii. ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
 - iii. nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
 - iv. nuk ka kryer deklarim të rremë;
 - v. subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.
4. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit dhe ka hartuar raportin përkatës, të cilin e ka përcjellë me shkresën nr. {***} prot., datë 02.11.2017, dhe e ka deklasifikuar pjesërisht me vendim të KDZH-së nr. {***}, datë 23.04.2018, duke bërë të njohur në përfundim papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Astrit Faqolli. Në analizë të këtij raporti, duke bërë një studim të thelluar të të dhënave të tij, duke administruar provat e tjera në lidhje me çështjen, Komisioni çmoi se informacioni mbi të cilin ka ardhur rekomandimi i DSIK-së rezultoi i pasaktë dhe i

¹ Shkresa nr. {***} prot., datë 09.11.2017.

pabazuar në prova dhe fakte, për pasojë subjekti Astrit Faqolli është konsideruar i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.

5. Këshilli i Lartë i Drejtësisë (në vijim “KLD”) ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale dhe në përfundim i ka dërguar Komisionit raportin përfundimtar, me shkresën nr. {***} prot., datë 22.01.2018. Në analizë të këtij raporti, relatori i çështjes pranë Komisionit, i ka propozuar trupit gjykues se subjekti i rivlerësimit klasifikohet si “i aftë”.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

6. Komisioni, me vendimin nr. 47, datë 25.07.2018, ka vendosur: “[...] Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Astrit Faqolli, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë [...]”.

6.1 Vendimi i mësipërm (nr. 47/2018) i Komisionit është bazuar në vlerësimin e të tria kritereve të rivlerësimit: vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale². Më konkretisht, pasi ka administruar të tria raportet e vlerësimit – raportin përfundimtar të ILDKPKI-së, raportin e DSIK-së dhe raportin e KLD-së – dhe pasi shqyrtoi provat dhe dëgjoi publikisht subjektin e rivlerësimit, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, Komisioni ka konkluduar sa vijon:

6.2 *Për vlerësimin e pasurisë: “[...] Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në mënyrë të pasaktë: a) pakësimin e gjendjes cash në deklarimin e tij në vitin 2006; b) deklarimin në “lekë të vjetër” në vitet 2004 dhe 2005 të kursimeve cash. [...]”.*³

Megjithatë, Komisioni arsyetoi se nuk gjeti prova që këto pasaktësi në deklarime të jenë bërë me qëllim fshehjen e burimit të të ardhurave apo pasurisë. Duke zbatuar parimin e proporcionalitetit, Komisioni arsyetoi se këto pasaktësi nuk ndikojnë në vlerësimin tërësor të pasurisë së subjektit dhe që pasaktësitë nuk cenojnë figurën e gjyqtarit dhe as besimin e publikut te drejtësia. Komisioni konkludoi se subjekti nuk ka në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikojë ligjërisht dhe ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tij dhe të personave të lidhur me të, në përputhje me pikën 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Më tej, pasi vuri re se subjekti ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së tij, nuk rezulton të ketë pasuri më të madhe se dyfishi i pasurisë së ligjshme, ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë dhe nuk është përpjekur të fshehë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij, Komisioni gjeti që shkaqet kushtetuese të cilat sjellin automatikisht prezumimin në favor të masës disiplinore të shkarkimit nuk vërtetohen. Sa më sipër, Komisioni konstatoi se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë.

6.3 *Për kontrollin e figurës: “[...] Komisioni çmon se [...] subjekti Astrit Faqolli konsiderohet i*

² Neni 4, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.”

³ Shih faqen 32 të vendimit të Komisionit.

përshtatshëm për vazhdimin e detyrës”⁴. Raporti i DSIK-së, dërguar Komisionit më 02.11.2017, deklasifikuar pjesërisht më 23.04.2018 për subjektin e rivlerësimit, vinte re që subjekti kishte qenë i saktë dhe kishte plotësuar me vërtetësi formularin e deklarimit për kontrollin e figurës, në përputhje me nenin 39⁵ të ligjit nr. 94/2016. Nga ana tjetër, raporti i DSIK-së konkludonte që subjekti i rivlerësimit është në kushtet e papërshtatshmërisë për “[...] vazhdimin e detyrës, pasi konsiderohet si individ i mundshëm për t’u vënë nën presion nga struktura kriminale, sipas përcaktimit të germës “c” të nenit 37 të ligjit nr. 84/2016”.

Duke iu referuar nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese, dhe pas analizës së thelluar dhe administrimit të provave dhe rrethanave lehtësuese që ka marrë parasysh grupi i punës së DSIK-së, Komisioni arriti në përfundimin që rekomandimi i DSIK-së është i pasaktë dhe i pabazuar në prova dhe fakte. Vendimi i Komisionit argumenton ndër të tjera se: *[...] konstatoi se informacioni i përcjellë nuk përmban elementet e parashikuara nga neni 38 i ligjit nr. 84/2016 dhe ai konsiderohet i paplotë. Informacioni në çdo rast duhet të jetë i bazuar mbi prova të sakta, kjo është edhe fryma e ligjit për krijimin e grupit të punës. Nëse Grupi i Punës nuk do të bëjë një verifikim të plotë, atëherë ai rrezikon të nxjerrë përfundime të gabuara dhe të rëndojë pozitën e subjekteve të rivlerësimit. Në këtë rast, Grupi i Punës nuk ka kryer verifikime të mëtijshme, duke arritur në konkluzion vetëm mbi bazën e informacionit të paverifikuar. [...] Për të krijuar bindjen e brendshme, si dhe për të plotësuar kuadrin e procesit hetimor administrativ, Komisioni administroi dhe shqyrtoi fashikullin e plotë të procesit të ndjekur nga subjekti në pozicionin e ... në vitin ... për rastin në fjalë.*-⁶ Në përfundim, Komisioni ka çmuar se subjekti i rivlerësimit është në kushtet e duhura ligjore për t’u konsideruar si i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës dhe, për rrjedhojë, ka arritur një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës.

6.4. Për vlerësimin e aftësive profesionale, sipas Komisionit, subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel kualifikues, duke e kategorizuar si “i aftë” dhe, për rrjedhojë, arrin nivel kualifikues të vlerësimit të aftësive profesionale.

⁴ Shih faqen 35 të vendimit të Komisionit.

⁵ Neni 39 parashikon: “1. Drejtoria e Sigurisë të Informacionit të Klasifikuar, në bashkëpunim me grupin e punës, brenda 60 ditëve nga konstituimi i grupit të punës, verifikon nëse informacioni është i saktë dhe nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar. Në përfundim të afatit 60-ditor, Drejtoria e Sigurisë të Informacionit të Klasifikuar mund t’i kërkojë Komisionit një zgjatje 30-ditore të afatit të verifikimit, në rast se është kërkuar informacion nga shtete të tjera. 2. Brenda 10 ditëve nga përfundimi i kontrollit, Drejtoria e Sigurisë të Informacionit të Klasifikuar, pas përgatitjes nga grupi i punës të dokumentit/raportit, ia paraqet atë Komisionit. Ky dokument/raport përcakton nëse subjekti i rivlerësimit ka plotësuar formularin e deklarimit për kontrollin e figurës, në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi; nëse ka informacion në deklarimin e tij ose gjetkë që tregon se subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, si dhe konstatimin në lidhje me përshtatshmërinë e tij për vazhdimin ose jo të detyrës. Ky dokument përmban informacion mbi kontaktet dhe kushtet e parashikuara në nenin 38 të këtij ligji. Informacioni nuk bëhet publik nëse ai rrezikon sigurinë e burimit, ose për shkak të një kushti të përcaktuar nga qeveria e një shteti tjetër.”

⁶ Faqja 34 - 35 e vendimit të Komisionit.

III. Shkaqet e ankimit

7. Komisioneri Publik, më datë 28.08.2018, ushtroi ankim ndaj vendimit të Komisionit nr. 47, datë 25.07.2018, që lidhet me subjektin e rivlerësimit Astrit Faqolli dhe kërkoi ndryshimin e këtij vendimi dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit. Sipas Komisionerit, nga gjendja e fakteve dhe e provave nuk krijohet bindja se subjekti i rivlerësimit arrin nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë së tij, në kuptim të nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016. Më konkretisht, në lidhje me kriterin e vlerësimit të pasurisë, referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe Kreut IV të ligjit nr. 84/2016, sipas Komisionerit Publik, vendimi i Komisionit nuk gjen mbështetje në aktet dhe provat e administruara gjatë hetimit administrativ.

7.1. Ndërkohë, Komisioneri Publik konstaton se, për sa i takon i) kriterit të kontrollit të figurës dhe ii) kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale, vendimi i Komisionit lidhur me z. Astrit Faqolli, bazohet në provat dhe faktet që janë administruar gjatë hetimit administrativ.

A. Shkaqet ankimore për vlerësimin e pasurisë

8. Shkaqet e ankimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë paraqiten si më poshtë:

8.1. Për pasurinë “Apartament banimi, me sipërfaqe 83,31 m²”, me adresë rr. “{***}”, Tiranë, në vlerën 42.300 euro, Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm, parashikuar nga pika 3 e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, pasi:

i. *Lidhur me burimin:* Në deklaratën e pasurisë (*vetting*) 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim të krijimit të kësaj pasurie të ardhurat familjare ndër vite, ndërkohë që në deklaratën periodike të pasurisë të vitit 2006 ka deklaruar 3 (tre) zëra lidhur me burimin: i) pakësim në vlerën 2.300.000 lekë nga gjendja e kursimeve *cash* në banesë, të akumuluar gjatë viteve 2003, 2004 dhe 2005; ii) hua nga {***} A.P., në vlerën 10.000 euro dhe iii) shitje automjeti tip Benz, në vlerën 250.000 lekë.

ii. *Lidhur me ligjshmërinë e të ardhurave:* Analiza financiare e Komisionit, si rrjedhojë e pranimit të pretendimit të subjektit mbi krijimin e shumës së kursimeve në vlerën prej 5.000.000 lekësh deri në vitin 2003, është e gabuar dhe nuk mbështetet në dokumentet provuese. Marzhi i fitimit për shitjen e barnave duhet të përlllogaritet maksimalisht 35%, në përputhje me Vendimin nr. 182, datë 25.04.1995, të Këshillit të Ministrave “Për shitjen e barnave”, i ndryshuar. Me këtë llogaritje, edhe duke e konsideruar xhiron në nivelin maksimal të fashës, sipas shkresës së DRT Elbasan, nr. {***} prot., datë 21.10.2016, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016, për të realizuar kursimin e deklaruar (5.000.000 lekë), që është përdorur i gjithi për blerjen e kësaj pasurie, referuar deklarimeve të tij në pyetësorët e dërguar nga Komisioni gjatë procesit të rivlerësimit.

iii. *Lidhur me analizën financiare për të llogaritur kursimin në vlerën prej 5.000.000 lekësh*, Komisioni nuk ka llogaritur si shpenzime një vlerë prej 500.000 lekësh, që vetë subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar në vitin 2004, si shpenzim për blerjen e (i) një trualli (vlera 150.000 lekë – blerë më 23.07.2003) dhe (ii) të një automjeti (vlera 350.000 – blerë më 22.01.2003).

iv. *Lidhur me kursimet e deklaruara në vitet 2004-2005*: Duke marrë në konsideratë të ardhurat e ligjshme të subjektit të rivlerësimit, kursimet e mundshme deri në fund të vitit 2003 dhe deklarimet e subjektit gjatë procesit të rivlerësimit, konkretisht kursimet e viteve 2004 dhe 2005 gabimisht janë deklaruar në lekë të vjetra, ndërkohë që shifra e vërtetë e kursimeve ka qenë respektivisht 100.000 lekë dhe 80.000 lekë, Komisioneri Publik arsyeton se subjekti i rivlerësimit nuk mbulon me të ardhura të ligjshme në kuptim të pikave 1 dhe 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, kursimet e deklaruara të përdorura për blerjen e kësaj pasurie për një shumë prej 1.167.787 lekësh. Subjekti i rivlerësimit nuk mbulon me të ardhura të ligjshme kursimet e deklaruara në vitin 2003, si dhe pagesën për blerjen e pasurisë “apartament”. Sipas Komisionerit Publik, duke deklaruar se shuma e kursyer prej 5.180.000 lekësh është përdorur e gjitha për pagesat për blerjen e apartamentit, subjekti ka kryer deklarim të pamjaftueshëm për pasurinë dhe burimet e krijimit në deklaratat periodike vjetore të pasurisë për vitet 2003-2006, si dhe në deklaratën e pasurisë (*vetting*) 2017.

v. *Lidhur me huan e marrë {***}, A.P-së, në vlerën 10.000 euro*: Komisioneri Publik sjell në vëmendje që në deklaratën periodike vjetore të pasurisë të vitit 2006, nga subjekti kjo hua është deklaruar të jetë kryer pa pasur për bazë kontratë, ndërkohë që huaja është formalizuar me deklaratë noteriale gjatë procesit të rivlerësimit, më datë 08.06.2018.⁷ Nga aktet e administruara në dosje, rezulton se nuk provohet me fakte dhe prova burimi i ligjshëm i kësaj të ardhure në momentin e krijimit të pasurisë, në momentin e blerjes së saj në vitin 2000. Mundësia huadhënëse e individëve në fjalë provohet vetëm në momentin që e kanë shitur këtë apartament, në vitin 2006. Kontrata e shitjes së apartamentit 135 m² në rr. “{***}”, Tiranë, e vitit 2006, shërben për të provuar ekzistencën e të ardhurave në momentin e huadhënies, por nuk justifikon burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë, në vitin 2000.

vi. *Lidhur me shitjen e automjetit Mercedes Benz*: Deklarimi i subjektit të rivlerësimit i vitit 2007, sipas të cilit ai pretendon se e ka shitur automjetin në vitin 2006 për një vlerë prej 250.000 lekësh, e cila më pas është përdorur për blerjen e apartamentit, është pranuar nga ana e Komisionit në kundërshtim me përmbajtjen e akteve të gjendura në dosjen e gjykimit. Nuk rezulton të jetë administruar ndonjë kontratë noteriale, sikundër ligji kërkon, për shitjen e këtij automjeti nga subjekti i rivlerësimit.

8.2. Për pasurinë “truall + ndërtesë tri kate, me sipërfaqe 32 m² (32 m² + 32 m² + 48 m²)”, në qytetin e Librazhdit, me vlerë 2.786.720 lekë⁸, Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i

⁷ Nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 08.06.2018.

⁸ Regjistruar në regjistrat hipotekor të ZVRPP Librazhd në vitin 2011.

rivlerësimit nuk ka pasur mundësi të mbulonte me të ardhura të ligjshme në vitin 2011 shumë prej 1,4 milionë lekësh. Për pasojë, subjekti ka bërë deklaram të pamjaftueshëm, parashikuar nga pika 3 e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, pasi të dyja burimet e deklaruara për krijimin e të ardhurave në vlerën prej 2983619 lekësh, që kanë shërbyer për fitimin e pronësisë së sendit të paluajtshëm – (i) kursimet e viteve 2007-2010 dhe (ii) huaja nga personi tjetër i lidhur, L.Rr. – nuk rezultojnë të jenë provuar se janë burime të ligjshme në masën e kërkuar, sikundër sanksionojnë pikat 1, 3 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

8.3. Lidhur me deklaramet kontradiktore të subjektit të rivlerësimit: Komisioneri Publik vlerëson se nga mënyra e formulimit të dispozitës dhe teknikës legjislative, kuptohet që likuiditetet mund të jenë në disa forma, përfshirë *cash-in*, llogari rrjedhëse, depozitë, bono thesari dhe huadhënie. Secila formë duhet deklaruar në mënyrë korrekte bashkë me vendndodhjen. Vetëm duke i paraqitur në zëra të veçantë, garantohet efektiviteti i kontrollit të likuiditeteve, përndryshe, nëse nuk identifikohet vendndodhja, nuk mund të realizohet kontrolli efektiv. Deklaramet e subjektit nuk rezultojnë në përputhje me dokumentet e vëna në dispozicion, duke krijuar një rrethanë specifike, e cila nuk rezulton të jetë analizuar si e tillë nga Komisioni.

8.4. Në vitin 2016, vit në të cilin subjekti deklaroi të ketë *shlyer huan prej 1 000 000 lekësh ndaj shtetasit L.Rr. dhe shumë 7.500 euro ndaj shtetasit A.P.*, nga verifikimi i deklaratave periodike vjetore të pasurisë të viteve 2014 dhe 2015, Komisioneri Publik konstaton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar respektivisht (në deklaratat periodike vjetore të pasurisë) në vitin 2014 kursime në *cash* jashtë sistemit bankar 300 000 lekë dhe në vitin 2015 gjendje në *cash* jashtë sistemit bankar 400 000 lekë. Sipas Komisionerit, në të dyja rastet subjekti në deklaratat periodike vjetore të pasurisë duket se i referohet gjendjes në momentin e deklaramit. Bazuar në deklaramet periodike vjetore të pasurisë, nga analiza financiare e të ardhurave dhe shpenzimeve deri në vitin 2016, konstatohet se subjekti nuk mbulon me të ardhura të ligjshme shlyerjet e deklaruara të detyrimeve dhe shpenzimet vjetore për vitin 2016.

IV. Shpjegimet dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit

9. Përkundër sa Komisioneri Publik parashtron, subjekti i rivlerësimit në prapësimet e tij theksoi se vendimi i Komisionit është i drejtë dhe i bazuar në provat e shqyrtuara gjatë hetimit administrativ dhe, si rrjedhojë, i krijoi bindjen Komisionit të vendosë të konfirmojë në detyrë subjektin e rivlerësimit. Subjekti, përfundimisht kërkoi:
- a) Riçeljen e hetimit gjyqësor.
 - b) Administrimin në cilësinë e provave të dokumenteve të përmendura në prapësime, si dhe të atyre që janë kërkuar dhe janë në pritje për t'i marrë.
 - c) Pasi të administrohen dhe të vlerësohen provat në tërësi, lënien në fuqi të vendimit nr. 47, datë 25.07.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

9.1. Në seancat dëgjimore të zhvilluara në datat 07.03.2019, 20.03.2019 dhe 21.03.2019, nëpërmjet përfaqësuesit të tij ligjor, Avokat Julian Mërtiri, subjekti i rivlerësimit theksoi se gjatë procesit të

hetimit administrativ, në përmbushje të detyrës pasi i kaloi barra e provës, ai ka paraqitur provat përkatëse për shqyrtim nga Komisioni. Duke qenë se në ankim Komisioneri Publik ka ngritur pretendime për shkaqe të reja, subjekti ka sjellë në cilësinë e provës akte të reja, pavarësisht se nuk i ka kaluar barra e provës. Në seancën e datës 20.03.2019, subjekti kërkoi nga trupi gjykues marrjen e dy provave nga trupi gjykues.

Të njëjtën kërkesë, subjekti e parashtroi edhe me shkresën e datës 12.04.2019. Konkretisht, subjekti i rivlerësimit kërkoi riçeljen e hetimit dhe:

- a) Marrjen e dokumentacionit për vitin ushtrimor janar-dhjetor 2013 për subjektin tregtar “{***}” ShPK (NIPT {***}) të cilit subjekti pretendoi se i ishte shitur malli i mbetur në procesin e mbylljes së biznesit farmaci, pronë e bashkëshortes, në vitin 2003. Sipas kërkesës së subjektit, trupi gjykues duhet të kërkonte informacion mbi situatën financiare të “{***}” ShPK, meqenëse Drejtoria Rajonale për Tatimpaguesit e Mëdhenj (në vijim “DRTM”) këtë informacion nuk mund t’ia jepte subjektit, për shkak të kufizimeve ligjore në fuqi. Sipas subjektit të rivlerësimit, DRTM-ja këtë informacion mund t’ia japë Kolegjit, si një prej institucioneve të ngarkuara me ligj për të kërkuar informacion.
- b) Marrjen e dokumentacionit që provon datën e shitjes së automjetit Mercedes Benz 240 në shumën e deklaruar në deklaratën periodike vjetore të pasurisë në vitin 2006 dhe ndërrimin e pronësisë së automjetit. Referuar shkresës nr. {***} prot., datë 20.03.2019, të Drejtorisë Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor Tiranë, e cila vërteton se dosja e mjetit dikur në pronësi të z. Faqolli ndodhet pranë Drejtorisë Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor Elbasan. Bashkë me dosjen, subjekti i rivlerësimit kërkoi marrjen e një kopjeje të kontratës dhe të aktit të transferimit të pronësisë së mjetit, për të provuar të kundërtën e pretendimit të Komisionerit Publik.

9.2. Kërkesa (për riçeljen e hetimit gjyqësor dhe marrjen e provave pranë të tretëve) bazohej në disa argumente. Sipas subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues duhet ta kishte shtrirë hetimin rreth fakteve të konsideruara të pavërtetuara nga ana e Komisionerit Publik, të cilat ishin të paaksesueshme për të, duke qenë se u përkasin subjekteve të tjera. Ligji i jep akses vetë Kolegjit në nenin 50⁹ të ligjit nr. 84/2016. Sipas subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues nuk u shpreh për këtë kërkesë të tij (për shtrirjen e hetimit gjyqësor) në drejtim të marrjes së këtyre të dhënave. Duke qenë se çështja në Kolegji shqyrtohet për shkak të ankimit nga Komisioneri Publik, leximi i

⁹ Neni 50 i ligjit nr. 84/2016, ndër të tjera, parashikon: “[...] 4. Me kërkesë të Komisionit ose Kolegjit të Apelit, bankat e nivelit të dytë dhe subjektet e tjera, që ushtrojnë aktivitete bankare dhe financiare në Republikën e Shqipërisë, janë të detyruara të japin informacion mbi depozitat, llogaritë dhe transaksionet e kryera nga subjekti i rivlerësimit ose personat e lidhur më të. Institucionet private rimburohen nga institucionet e rivlerësimit për çdo kërkesë, duke përfshirë kërkesat në bazat e të dhënave dhe kopjet e dokumenteve të lëshuara. [...]”.

kombinuar i nenit 47 të ligjit nr. 49/2012¹⁰ dhe i nenit 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016¹¹ sugjeron që duke mos qenë subjekti i rivlerësimit parashtruesi i ankimit, edhe paraqitja e provave nuk i bie barrë atij.

9.3. Subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mundësi të merrte provat në fjalë gjatë hetimit administrativ nga Komisioni, pasi atij nuk i ka kaluar asnjëherë barra e provës për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera, ose për të provuar të kundërtën e pretendimeve të Komisionerit Publik. Sipas subjektit, trupi gjykues duhet ta konsideronte kërkesën e parashtruar në seancën e datës 20.03.2019, nën dritën e nenit 51 të ligjit nr. 49/2012 dhe të shtrinte ose përsëriste hetimin, duke konstatuar gjendjen në kushtet e njëjës nga situatat e këtij neni.

Lidhur me pasuritë në të cilat mbështeten shkaqet e ankimit nga Komisioneri Publik, subjekti i rivlerësimit parashtrroi sa vijon:

A. Për pasurinë nr. 1¹²

Në lidhje me kursimin 5.000.000 lekë deri në vitin 2003:

- Përveç të ardhurave nga paga si gjyqtar nga muaji nëntor 1997 e në vijim, subjekti ka qenë i punësuar si jurist pranë Këshillit të Rrethit Librazhd për periudhën tetor 1994 – nëntor 1997. Në mbështetje të këtij pretendimi, ai paraqiti vërtetim nga Drejtoria Rajonale Nr. {***} Elbasan/Instituti i Sigurimeve Shoqërore.
- Përlllogaritja e fitimit në 35% të xhiros nga Komisioneri, lidhur me farmacinë në pronë të bashkëshortes së subjektit, është e pasaktë. Përlllogaritja e kryer nga Komisioni me 40% është e saktë.
- Përkundrejt pretendimit të Komisionerit Publik se të ardhurat kanë qenë 6014.356 lekë dhe kursimet 5.000.000 lekë – 83,13 % kursime nga të ardhurat, një shumë e pamundur për t'u kursyer, dhe si e tillë e pavërtetë sipas Komisionerit – shpenzimet familjare të llogaritura janë të drejta, duke pasur parasysh të dhënat e INSTAT-it dhe rrethanat familjare të subjektit të rivlerësimit për periudhën në fjalë.
- Kolegji duhet të marrë në konsideratë që me mbylljen e farmacisë, malli që ka qenë gjendje është kthyer në depon farmaceutike nga ku ishte blerë dhe nga kjo e fundit është kthyer ekuivalenti i çmimit të paguar fillimisht për blerjen e mallit, rreth 2.000.000 lekë. Subjekti kërkoi nga trupi gjykues kohë shtesë për të siguruar dokumentacionin e nevojshëm nga depoja farmaceutike.

¹⁰ Neni 47 i ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” parashikon: “Në ankim nuk mund të paraqiten fakte të reja dhe të kërkohen prova të reja, përveçse kur ankuesi provon se pa fajin e tij nuk ka mundur t’i paraqesë këto fakte ose t’i kërkojë këto prova në shqyrtimin e çështjes në gjykatën administrative të shkallës së parë, në afatet e parashikuara në këtë ligj.”

¹¹ Neni 65, pika 1 parashikon: “1. Procesi gjyqësor në Kolegjin e Apelit kryhet në përputhje me rregullat e parashikuara në nenet 47, 48, pika 1; 49, 51 dhe 55 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

¹² Apartament banimi me sipërfaqe 83,31 m², me adresë rr. “{***}”, Tiranë.

- Lidhur me aftësinë huadhënëse të shtetasit A.P. për shumën prej 10.000 eurosh, si dhe me mundësitë financiare të tij për të blerë apartamentin në rr. “{***}”, në shumën 41.000 dollarë, subjekti paraqiti dokumentacion bankar nga {***}, {***} dhe {***}.
- Për sa i përket mosdeklarimit të huas 10.000 euro nga A.P në deklaratën e pasurisë (*vetting*) 2017, siç pretendon Komisioneri Publik, duke u qëndruar sqarimeve të dhëna para Komisionit, subjekti u shpreh se huaja nuk është deklaruar pasi ka qenë e shlyer me të ardhura nga kursimet familjare në momentin e deklarimit, dhe se tashmë burimi i krijimit të pasurisë është kursime nga të ardhurat familjare.
- Lidhur me mosdeklarimin e shpenzimeve të mobilimit në vlerën 850.000 lekë në deklaratën periodike vjetore të pasurisë të vitit 2006, subjekti i rivlerësimit theksoi se deklarimi i shpenzimeve është vendosur në ligj vetëm në vitin 2012.
- Huaja nga A.P është marrë pas pagimit të çmimit të plotë të apartamentit nga subjekti i rivlerësimit, por është përdorur për mobilimin dhe jo për të paguar blerjen e apartamentit.
- Lidhur me pretendimin e Komisionerit Publik se shitja e automjetit Mercedes Benz 240 në vlerën 250.000 lekë, nuk provohet, subjekti thekson se shitja në 2006-ën është fakt. Për shkak të kohës që ka kaluar, subjekti i rivlerësimit nuk disponon kontratën dhe pret përgjigje nga ILDKPKI-ja për një kopje të saj që mund të jetë ende në atë institucion.

B. Për pasurinë nr. 2¹³

- Nga huaja e marrë A.P. në shumën 10.000 euro, 850.000 lekë janë përdorur për mobilim, ndërsa diferenca prej 400.000 lekësh – gjendje *cash* në banesë – është përdorur për pagimin e çmimit të ndërtimit. Nga Komisioneri Publik, pa të drejtë nuk merret në konsideratë kjo shumë.
- Shtetasi L.Rr. ka pasur mundësi huadhënëse të shumës 1.000.000 lekë, pavarësisht nga blerjet e vitit 2011, të vëna në dukje nga Komisioneri Publik në seancë, duke marrë parasysh:
 - Të ardhurat nga emigracioni.* Dokumentacioni i sjellë në cilësinë e provës, për sa i përket punësimit të personit tjetër të lidhur, L.Rr., është i paplotë për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar. Përmes shënimit informues me nr. {***} prot., datë 03.12.2018, të Degës Rajonale 1 të Rrogëtarëve, Zyra e Regjistrimit të të Siguruarve, Veria, Greqi, vërtetohet se shtetasi L.Rr. ka punuar: a) në vitin 2000 – 32 ditë; b) në vitin 2001 – 213 ditë; c) në vitin 2002 – 139 ditë dhe ka përfituar 5244 euro të ardhura; ç) në vitin 2003 – 44 ditë dhe ka përfituar 1.683 euro të ardhura.
 - Të ardhurat nga aktiviteti privat.* Totali i xhiros për periudhën 2005-2009 është 20427484 lekë. Tatimi mbi fitimin e thjeshtuar është paguar për të gjithë aktivitetin me kuotë fikse, sipas fashës së xhiros dhe kategorizimeve të legjislacionit përkatës.

9.4. Për të mbështetur sa më sipër, subjekti i rivlerësimit paraqiti:

¹³ *Truall + ndërtesë trekatëshe, me sipërfaqe 32 m², në qytetin e Librazhdit.*

- a)** vërtetim nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore për të ardhurat e përfuara si jurist në Këshillin e Rrethit Librazhd, për periudhën 01.10.1994 - 30.11.1997;
- b)** dokumentacion bankar nga {***}, {***} dhe {***}, me anë të të cilit vërtetohen pagesat e kryera në emër të shtetasit A.P.;
- c)** dokumentacion për të dhënat e karrierës sportive të shtetasit A.P.;
- ç)** korrespondencën e Federatës Shqiptare të Futbollit me Klubin e Futbollit Delemont për përfshirjen e shtetasit A.P në kombëtaren shqiptare të futbollit;
- d)** kontratën e angazhimit si futbollist të shtetasit A.P me Klubin e Futbollit Delemont, Zvicër, datë 02.07.1997;
- dh)** vërtetim nga Klubi i Futbollit Concordia, datë 06.11.2018, për angazhimin dhe pagesat e përfuara nga shtetasi A.P. pranë këtij klubi;
- e)** fotokopje gazetash për karrierën sportive të shtetasit A.P.;
- ë)** vërtetim nga ISSh-ja se shtetasi L.Rr. ka punuar pranë shoqërisë “{***}” ShPK, Gramsh, Elbasan për periudhën 18.05.2011 - 30.10.2011;
- f)** kërkesë për informacion dhe dokumentacion, e datës 20.10.2018, e shtetasit L.Rr., drejtuar Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë;
- g)** shkresë kthim përgjigjeje nr. {***} prot., datë 26.10.2018, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, drejtuar subjektit L.Rr., bashkëlidhur së cilës gjenden printime nga sistemi me të dhëna financiare për vitet 2005, 2008 dhe 2009;
- gj)** vërtetim të shoqërisë “{***}” ShPK, të datës 10.12.2018, për punësimin e shtetasit L.Rr. pranë kësaj kompanie;
- h)** nxjerrje llogarie të datës 28.02.2019 nga Banka {***} për shtetasin L.Rr., për periudhën 04.02.2009 - 31.12.2012;
- i)** nxjerrje llogarie të datës 30.10.2018 nga {***} për shtetasit A.A. ose L.Rr., për periudhën 19.01.2006 - 30.10.2018;
- j)** nxjerrje llogarie të datës 15.10.2018 nga {***} për shtetasin L.Rr., për periudhën 01.01.2008 - 27.09.2018;
- k)** nxjerrje llogarie e datës 15.10.2018 nga {***} për shtetasin L.Rr., për periudhën 01.10.2015 - 27.09.2018;
- l)** nxjerrje llogarie e datës 15.10.2018 nga {***} për shtetasin A.Rr., për periudhën 01.01.2008 - 27.09.2018;
- ll)** nxjerrje llogarie nga {***} për shtetasin L.Rr., për periudhën 01.03.2010 - 31.12.2012, sipas së cilës llogaria është kredituar më datë 19.03.2010 me 3.500.000 lekë, dhe në të njëjtën datë është tërhequr nga shtetasi L.Rr.;
- m)** shkresë e Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore të Bashkisë Tiranë, me nr. {***} prot., datë 03.01.2019, që tregon se niveli i xhiros për subjektin L.Rr. me NIPT {***} (Person Fizik), në vitin 2007 ka qenë 7-8 milionë lekë, xhiro e cila nga data e licencimit, 01.01.2005, deri në datën e kalimit në status pasiv, 24.10.2012, rezulton e pandryshuar;
- n)** shkresë e Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore të Bashkisë Tiranë, me nr. {***} prot., datë 03.01.2019, që tregon se subjekti L.Rr., me NIPT {***} (Person Fizik) ka

likuiduar detyrimet vendore deri në datën e kalimit në statusin pasiv, 24.10.2012;
nj) ekstrakt historik i shoqërisë “{***}” ShPK, i datës 28.02.2019;
o) shënim informues, me nr. {***} prot., datë 03.12.2018, i Degës Rajonale 1 të Rrogëtarëve, Zyra e Regjistrimit të të Siguruarve, Veria, Greqi, për punësimin e shtetasit L.Rr. në Greqi;
p) certifikatë martesë e Zyrës së Gjendjes Civile Librazhd, e datës 29.10.2018, e shtetasve L.Rr. dhe A.A.

V. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit

10. Trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në nenin D, pikat 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe në nenin 30 e vijues të ligjit nr. 84/2016, ka vlerësuar shkaqet në ankim të paraqitura nga Komisioneri Publik mbi rezultatet e kontrollit të kryer nga Komisioni për kriterin e vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, personin e lidhur dhe personat e tjerë të lidhur, në përputhje me kriteret që parashikojnë dispozitat e mësipërme dhe bazuar në aktet shkresore që janë administruar në dosje, si dhe prapësimet e subjektit të rivlerësimit.

10.1. Për pasurinë apartament banimi, me sipërfaqe 83,31 m², me adresë rr. “{***}”, Tiranë, porositur në vitin 2006, në vlerën 42.300 euro dhe formalizuar me kontratën e shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 15.08.2015, me burim (sipas deklaratës së pasurisë (*vetting*) 2017) të ardhurat familjare ndër vite, trupi gjykues i Kolegjit mori në shqyrtim këto akte:

- i) kontratë sipërmarrjeje me shoqërinë “{***}” ShPK, të datës 10.01.2006;
- ii) kontratë shitblerjeje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 15.08.2015, lidhur ndërmjet Astrit Faqollit dhe shoqërisë “{***}” ShPK;
- iii) shkresë me nr. {***} prot., datë 10.10.2017, e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, bashkëlidhur së cilës gjendet kartela e pasurisë së paluajtshme me të dhënat: nr. dok. {***}, datë regjistrimi 26.08.2015, datë e lëshimit të certifikatës 26.08.2015;
- iv) vërtetim nr. {***} prot., datë 24.10.2016, i Këshillit të Lartë të Drejtësisë që evidenton se z. Faqolli ka qenë me detyrë inspektor në Inspektoratin e KLD-së në periudhën nga 31.07.2003 – 05.04.2010 dhe ka përfituar shumën prej 7.300.904 lekësh të ardhura neto nga paga si inspektor dhe shumën prej 474.150 lekësh nga pagesat për dietat brenda vendit;
- v) vërtetim, datë 06.10.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan që evidenton ushtrimin e detyrës së gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Librazhd, për periudhën 16 nëntor 1997 - 31 gusht 2003, si dhe që ka përfituar shumën prej 2.534.262 lekësh¹⁴;
- vi) kontratë sipërmarrjeje nr. {***} rep., datë 27.01.2000;
- vii) mandatarkëtim, datë 26.01.2000, arkëtuar nga M.H., 20.000 dollarë;
- viii) mandatarkëtim, datë 17.06.2000, arkëtuar nga M.H., shuma 3.000 dollarë;

¹⁴ Nga shkresa e KLD-së dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, konstatohet se ka mbivendosje në periudhën e pagesës për muajin gusht 2003.

- ix) mandatarkëtim, nr. {***}, datë 01.08.2001, arkëtuar nga A.P., shuma 14300 dollarë amerikanë;
- x) mandatarkëtim nr. {***}, datë 11.12.2001, arkëtuar nga A.P., shuma 4000 dollarë amerikanë;
- xi) kontratë shitjeje apartamenti nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 22.12.2000, midis shoqërisë “{***}” ShPK dhe blerësve A.P. e S.H.;
- xii) certifikatë pronësie në emër të shtetasit A.P.P. dhe S.H., lëshuar më datë 07.06.2006;
- xiii) prokurë e posaçme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 11.12.2006, pranë noterit A.T., me të përfaqësuar A.P. dhe S.H. për emërimin e përfaqësuesit të posaçëm Astrit Faqolli për shitjen e apartamentit;
- xiv) kontratë shitjeje pasurie të paluajtshme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 12.12.2006;
- xv) deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 08.06.2018, e z. P.P. ({***} i subjektit dhe {***} i z. A.P.) për dhënien *cash* të shumës 5900.000 lekë pas mbajtjes së shumës prej 10000 eurosh nga z. Astrit Faqolli, nga vlera e shitjes së apartamentit të z. A.P.;
- xvi) deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 08.06.2018, e z. A.P. lidhur me historikun e veprimeve për dhënien e huas në vlerën 10000 euro z. Astrit Faqolli;
- xvii) shkresë nr. {***} prot., datë 31.01.2018, e ZVRPP Tiranë, e cila informon se në emër të subjektit rezulton e regjistruar pasuria nr. {***}, vol. {***}, f. {***}, Zona Kadastrale {***}: “[...] lloji i pasurisë: apartament me sipërfaqe 83,31 m². Bashkëlidhur është dërguar kartela përkatëse e pasurisë, kontrata e sipërmarrjes e datës 10.01.2006, si dhe kontrata e shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 15.08.2015”;
- xviii) shkresë nr. {***} prot., datë 06.02.2018, e OSHEE-së, e cila informon: “Referuar sistemit të faturimit, kontrata {***} rezulton në emër të Astrit Faqollit, e cila është hapur më datë 11.04.2006 dhe nuk ka fatura të palikuidera”;
- xix) shkresë nr. {***} prot., datë 10.01.2018, e ISSh-së, e cila informon: “Të dhëna për kontributet që mbliidhen dhe dërgohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nëpërmjet WebService, i disponojmë nga viti 2012 e në vazhdim. Në to rezulton se subjekti I.F është e punësuar në kompaninë “{***}” ShPK dhe për të paguhen kontributet përkatëse”;
- xx) shkresë nr. {***} prot., datë 09.02.2018, e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, e cila informon mbi të ardhurat që ka realizuar nga punësimi znj. I.F., për periudhën dhjetor 2011 - dhjetor 2017;
- xxi) shkresë nr. {***} prot., datë 26.02.2018, e Drejtorisë Rajonale Tatimore Elbasan, e cila ndër të tjera, informon: “Tatimpaguesi I.F., me NIPT {***}, ka kaluar në status pasiv qysh prej datës 23.06.2010 dhe për këtë shkak nuk disponohen të dhëna për qarkullimin dhe fitimin/humbjen në vite. Tatimpaguesi nuk ka detyrime në kohë reale. Nuk disponohen të dhëna mbi pasqyrat financiare dhe për kontributet e sigurimeve shoqërore të kaluara”;

- xxii) shkresë nr. {***} prot., datë 22.01.2018, e QKB-së, e cila informon: “Nga verifikimi i kryer mbi bazën e emrit, si kriter i vetëm kërkimi, rezulton se figuron i regjistruar një subjekt me emrin I.F., si person fizik, pajisur me NUIS {***}, i cili nuk ka kryer plotësimin e të dhënave në QKB”;
- xxiii) shkresat nr. {***} prot., datë 23.02.2018, dhe nr. {***} prot., datë 12.03.2018, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan; shkresë nr. {***} prot., datë 20.02.2018, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës dhe shkresën nr. {***} prot., datë 27.02.2018, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, të cilat kanë konfirmuar se: “Nuk ka procese të zhvilluara nga subjekti i rivlerësimit me dhe për shoqërinë “{***}” ShPK”.

10.1.1. Lidhur me pretendimin e Komisionerit Publik se ka mospërputhje në deklarinë e burimit të kësaj pasurie midis deklaratës së pasurisë (vetting) 2017 dhe deklaratës periodike vjetore të vitit 2006, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se në deklaratën periodike vjetore të pasurisë së vitit 2006, subjekti deklaroi si burim pakësimin e gjendjes *cash* prej 2.300.000 lekësh, të akumuluar në vitet 2003, 2004 dhe 2005, huan 10.000 euro nga {***} A.P. dhe shitjen e automjetit tip Mercedes Benz, në vlerën 250.000 lekë. Nga ana tjetër, në deklaratën e pasurisë (vetting) 2017, si burim për krijimin e kësaj pasurie, subjekti ka deklaruar të ardhurat familjare ndër vite. Trupi gjykues çmon që pretendimi i subjektit të rivlerësimit se në momentin e plotësimit të deklaratës së pasurisë (vetting) 2017, huaja në fjalë ishte shlyer me të ardhurat familjare në vite dhe, për pasojë, ishte e panevojshme të detajohej, nuk qëndron. Në nenin D të Aneksit të Kushtetutës parashikohet se subjekti i rivlerësimit dorëzon një deklaratë të re dhe të detajuar të pasurisë, në përputhje me ligjin. Ky përcaktim kushtetues është shtjelluar më tej në nenin 32, “Deklarimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016 që parashikon se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, së bashku me deklaratën e pasurisë, paraqesin të gjitha dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive. Orientimin praktik të parashikimeve ligjore e kanë përcaktuar rregullat e udhëzimit nr. 4095/2016 të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së. Konkretisht, pika 7 parashikon se për çdo pasuri në pronësi të paluajtshme, të luajtshme, likuiditete, vlerën e aksioneve, letrave me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim etj., subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, duhet të deklarojë burimin, në momentin e krijimit për secilën prej tyre, duke bashkëlidhur dokumentacionin ligjor për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit për secilën pasuri, në momentin e fitimit të tyre. Më tej, në formularin e deklaramit të pasurisë për procesin e rivlerësimit¹⁵, në rubrikën “Deklarimi i pasurive”, përcaktohet qartësisht se objekt i deklaramit janë:

[...] Të gjitha pasuritë e akumuluar ndër vite, deri në ditën e dorëzimit të deklaratës së pasurisë, sipas nenit 3, pika 11 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, burimet e krijimit të tyre dhe të drejtat reale mbi to, të ndodhura brenda dhe jashtë vendit, të cilat ndodhen në pronësi, në posedim ose në përdorim nga subjekti i rivlerësimit apo në bashkëpronësi të tij me

¹⁵ Miratuar si shtojcë 2 e ligjit nr. 84/2016.

bashkëshortin/en, bashkëjetuesin/en, fëmijët në moshë madhore dhe/ose persona të tjerë të lidhur.

Po aty, lidhur me shpjegimin dhe nivelin e detajimit, përfshirë edhe burimin, formulari shprehimisht kërkon përshkrim të hollësishëm për:

[...] llojin, sipërfaqen, adresën ku ndodhen, vitin e krijimit, vlerën në lekë apo në valutë që pasqyrohet në dokumentacionin që dispononi, çmimin e blerjes, në mungesë të dokumenteve shumë e shpenzimeve që keni kryer, pjesën takuese që zotëroni dhe burimet e krijimit të çdo lloj pasurie të regjistruar ose jo në regjistrat publikë. [...]

10.1.2. Bazuar në sa më sipër dhe pas analizës së mënyrës së përshkrimit të burimit të kësaj pasurie nga subjekti në deklaratën e pasurisë (*vetting*) 2017, pretendimi i Komisionerit Publik se subjekti i rivlerësimit ka qenë kontradiktor në deklarinimin e burimit të kësaj pasurie, referuar deklaratës periodike të pasurisë së vitit 2006 dhe deklaratës së pasurisë (*vetting*) 2017, është i drejtë. Për rrjedhojë, trupi gjykues konstaton se subjekti ka kryer deklarinim të pasaktë për burimin e krijimit të kësaj pasurie.

10.1.3. Lidhur me pretendimin e Komisionerit Publik mbi ligjshmërinë e një pjese të të ardhurave në krijimin e shumës së kursimeve në vlerën prej 5.000.000 lekësh deri në vitin 2003, trupi gjykues i Kolegjit, nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, kreu analizën financiare të të dhënave referuar legjislacionit në fuqi, konkretisht Vendimit nr. 182, datë 25.04.1995, të Këshillit të Ministrave “Për çmimin e shitjes së barnave”, i ndryshuar. Si rrjedhojë e zbatimit të përlllogaritjeve të përcaktuara nga ky akt nënligjor, në rrethanat faktike të subjektit, trupi gjykues vëren se edhe nëse përlllogaritet çmimi më i lartë i mundshëm i shitjes, konkretisht 35 për qind (%) mbi çdo send të tregtuar nga farmacia e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit (referuar edhe pretendimit të subjektit të rivlerësimit në seancën publike në Kolegj dhe gjatë hetimit administrativ në Komision), subjekti i rivlerësimit do të ishte gjithsesi në pamundësi që deri në tetor 2003 të kursente më shumë se 3.434.859 lekë. Nëse marzhi i fitimit përlllogaritet 35% mbi çmimin e blerjes, kursimi maksimal nga ky biznes mund të arrinte deri në 3.149.859 lekë. Kjo përlllogaritje e trupit gjykues ka për bazë xhiron dhe fitimet e raportuara nga biznesi në fjalë në vitet 1999-2003 në organet tatimore. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk provoi me dokumentacion burimin e ligjshëm të një pjese të kursimeve të pretenduara.

10.1.4. Lidhur me pretendimin e Komisionerit Publik se Komisioni nuk ka llogaritur vlerën prej 500.000 lekësh si shpenzime të subjektit të rivlerësimit (150.000 lekë blerja e truallit në Librazhd më datë 23.07.2003 dhe 350.000 lekë blerja e automjetit më datë 22.01.2003) në analizën financiare për të llogaritur kursimin në vlerën prej 5.000.000 lekësh, trupi gjykues i Kolegjit vëren se kjo vlerë është marrë parasysh në analizën financiare të kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor në Kolegj, për llogaritjen e kursimeve të mundshme të subjektit të rivlerësimit, detajuar në paragrafët në vijim (10.1.5 dhe 10.1.6).

10.1.5. Komisioneri Publik më tej pretendon se Komisioni ka gabuar kur ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit mbulon me të ardhura të ligjshme kursimet e deklaruara në vitet 2004 dhe 2005 dhe

që deklarimi i subjektit të rivlerësimit me përdorimin e konceptit të monedhës në “lekë të rinj” dhe “lekë të vjetër” ishte i paqëllimtë dhe i kryer vetëm në deklaratimet periodike dhe jo në deklaratën (vetting) 2017, është i gabuar. Trupi gjykues i Kolegjit pasi shqyrtoi aktet në fashikull, përfshirë edhe shpjegimet e dhëna nga subjekti në procesin e hetimit administrativ, vlerëson se ky arsyetim i Komisionit është në tejkalim të tagrave të këtij të fundit, pasi bie ndesh me frymën e dispozitave të Aneksit të Kushtetutës¹⁶ dhe me nenin 32, pika 5¹⁷ e ligjit nr. 84/2016. Sipas këtyre dispozitave, në funksion të procesit të rivlerësimit, institucionet e rivlerësimit shqyrtojnë deklaratat e subjektit dhe bashkëpunojnë me institucionet e tjera për të konfirmuar vërtetësinë dhe saktësinë e deklarimeve. Për rrjedhojë, saktësia e deklaratave të subjektit është e rëndësishme për të kuptuar saktësisht gjendjen reale financiare të tij dhe për të vërtetuar nëse ai ka pasur burime të mjaftueshme dhe të ligjshme për krijimin e pasurisë. Jo pa qëllim, ligji e ka ngarkuar subjektin me detyrimin për të kryer deklaram të saktë dhe të plotë. Leximi veçmas apo në harmoni i dispozitave kushtetuese dhe atyre të ligjit nr. 84/2016, përfshirë edhe dy dispozitat e sipërpërmendura, nuk duket se lënë vend që institucionet e rivlerësimit të hetojnë qëllimin e subjekteve në procesin e deklarimeve të interesave periodikë vjetorë ndër vite. Edhe shpjegimi i vetë subjektit të rivlerësimit se ai i ka deklaruar kursimet e vitit 2004 dhe 2005, përkatësisht në vlerat 1.000.000 lekë dhe 800.000 lekë, nuk duket se qëndron. Brenda të njëjtave deklarata, përkatësisht atyre të 2004-ës dhe 2005-ës, subjekti pretendon të ketë gabuar vetëm në deklarin e kursimeve në “lekë të vjetër”, ndërkohë që të ardhurat janë deklaruar në “lekë të rinj”. Si gjyqtar, prej tij pritet seriozitet në plotësimin e deklaratave zyrtare të rëndësisë që paraqesin deklaratat periodike vjetore. Në funksion të shkaqeve të ankimit të ngritura nga Komisioneri Publik për këtë pasuri dhe këto deklarata të subjektit dhe të prapësimeve të këtij të fundit në seancë, u krye analiza financiare në Kolegj. Nga kjo e fundit, rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk kishte mundësi t'i realizonte këto kursime bazuar në analizën e të ardhurave nga paga e atij vetë, nga paga dhe të ardhurave nga biznesi i personit të lidhur përlllogaritur sipas xhiros së deklaruar, siç shpjegohet më sipër, në paragrafin 10.1.3.

Nga analiza financiare rezulton se mundësia teorike e subjektit të rivlerësimit për kursim në fillim të vitit 2004 arrin deri në vlerën 3.193.779 lekë, kurse të ardhurat për atë vit arrijnë në vlerën 1.138.133,13 lekë. Shpenzimet familjare të subjektit për vitin 2004 përlllogariten në vlerën 281.592

¹⁶ Neni Ç/4 i Aneksit të Kushtetutës parashikon: “[...] Kolegji i Apelimit, sipas rastit, përmes personelit të tyre, Komisionerit Publik, vëzhguesit ndërkombëtar, shqyrton deklaratat e subjektit të rivlerësimit për të shkuarën e tij, interviston personat e përmendur në deklaratë ose persona të tjerë, si dhe bashkëpunon me institucione të tjera shtetërore ose të huaja për të konfirmuar vërtetësinë dhe saktësinë e deklarimeve. Komisioni, Kolegji dhe vëzhguesit ndërkombëtarë kanë akses të drejtpërdrejtë në të gjitha bazat e të dhënave qeveritare, përveç atyre që janë klasifikuar “sekret shtetëror”, duke përfshirë edhe dosjet personale të të rivlerësuarit, të dhënat statistikore, dosje të përzgjedhura për rivlerësim, vetëvlerësimet, mendimet e eprorëve, të dhënat për trajnimet dhe ankimet ndaj të rivlerësuarve, rezultatet e verifikimit të ankesave, vendimet për marrjen e masave disiplinore ndaj të rivlerësuarve, të dhënat për pronat e të rivlerësuarit, llogaritë bankare, të dhënat tatimore, të dhënat për automjetet, të dhënat për hyrje-daljet në kufi, si dhe çdo dokument tjetër të dobishëm. Komisioni ose Kolegji mund të urdhërojë individë dhe shoqëri tregtare të dëshmojnë ose të japin prova në përputhje me ligjin.”

¹⁷ Neni 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 parashikon: “[...] 5. Deklarimet e interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji i Apelimit.”

lekë (bazuar në standardet e INSTAT-it, të referuara nga ILDKPKI-ja¹⁸). Për të njëjtin vit, në deklarin e tij periodik, subjekti shprehet se ka shtuar në formën e kursimeve 1.000.000 lekë. Si rrjedhojë, shuma e kursimeve në fund të vitit 2004, në total, përfshirë edhe ato të mbartura nga vitet e mëparshme, shkon në 4.193.779 lekë. Nga përlllogaritja e diferencës mes të ardhurave të vitit 2004 dhe kursimeve të vitit 2003 nga njëra anë (totali: 4.331.912,13 lekë¹⁹), dhe shpenzimeve familjare dhe kursimeve të pretenduara nga subjekti në gjendje deri në fund të vitit 2004, në vlerën 4.475.371 lekë²⁰, nga ana tjetër, rezulton se kursimi i shumës 1.000.000 lekë – sipas deklaratës periodike vjetore 2004 – është i pambështetur në burime të ligjshme për 143.458 lekë.

Për vitin 2005: rezulton se si pasojë e kursimeve të viteve të mëparshme, gjendja financiare e mundshme në fillim të vitit shkon në vlerën 4.050.320,13 lekë (e përbërë nga kursimet e mundshme në vitin 2003 dhe në vitin 2004). Të ardhurat për vitin 2005 janë në vlerën 1.072.166,18 lekë (paga e subjektit si inspektor i KLD-së, si dhe të ardhurat nga punësimi i bashkëshortes). Shpenzimet familjare të subjektit për këtë vit përbëhen nga shpenzimet e jetesës (sipas standardeve të INSTAT-it të referuara nga ILDKPKI-ja, përlllogaritur për rrethanat familjare përkatëse) dhe shpenzimet e udhëtimit bazuar në të dhënat e sistemit TIMS, në një shumë prej 815.014,6 lekësh. Subjekti ka deklaruar shtesë prej 800.000 lekësh në formë kursimesh që, si rrjedhojë, e çon rezultatin e kursimeve në fund të vitit 2005 në vlerën 4.850.366,7 lekë. Nga përlllogaritja mes të ardhurave dhe kursimeve të mundshme deri në fillim të vitit 2005 (4.050.232,13 lekë + 1.072.166,18 lekë), duke zbritur shpenzimet (815.014,6 lekë), rezulton se vlera e pretenduar si kursim në fund të vitit 2005 është e pambështetur në burime të ligjshme për shumën 542.895 lekë.

10.1.6. *Sipas Komisionerit Publik, subjekti i rivlerësimit nuk mbulon me të ardhura të ligjshme kursimet e deklaruara për blerjen e apartamentit në Tiranë, për një vlerë prej 1.167.787 lekësh.* Analiza financiare e kryer në Kolegj, në funksion të shqyrtimit të të gjitha shkaqeve të ankimit të parashtruara nga Komisioneri Publik në këtë çështje, tregon se pretendimi i Komisionerit Publik duhet pranuar. Trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk arrin të mbulojë me të ardhura të ligjshme pasurinë e krijuar (apartament dhe gjendje likuiditetesh *cash*) dhe shpenzimet për vitin 2006 në vlerën 1.985.170,3 lekë.

Më konkretisht, nga analiza financiare për vitin 2006, rezulton se si pasojë e kursimeve të viteve të mëparshme, gjendja financiare e kursimeve të mundshme në fillim të vitit shkon në vlerën 4.307.471,71 lekë. Kjo shumë përfshin kursimet e mundshme të viteve 2003, 2004 dhe 2005.²¹ Të ardhurat për vitin 2006 janë 2.483.196,7 lekë (përfshirë të ardhurat nga paga e subjektit si inspektor i KLD-së, të ardhurat për pagesën e lejes së lindjes për bashkëshorten nga ISSh-ja dhe huaja nga personi tjetër i lidhur, shtetasi A.P.). Shpenzimet familjare të subjektit për këtë vit përlllogariten në

¹⁸ Shkresa nr. {***} prot., datë 04.03.2019, administruar dhe regjistruar pranë Kolegjit me nr. {***} prot., datë 04.03.2019.

¹⁹ Respektivisht: të ardhurat 3.193.779 lekë, ndërsa kursimet 1.138.133,13 lekë.

²⁰ Respektivisht: 281.592 lekë shpenzime jetese dhe 4.193.779 kursime, përfshirë edhe ato të mbartura nga vitet më parë.

²¹ Respektivisht: kursimet në 2003-shin në vlerën 3.193.779 lekë, në 2004-ën në vlerën 856.541,13 lekë dhe kursimet në 2005-ën në vlerën 257.151,58 lekë.

vlerën 1516063 lekë²². Vlera e pasurisë apartament të blerë në këtë vit (2006) është 5250000 lekë. Si rrjedhojë, totali i shpenzimeve të subjektit, përfshirë edhe blerjen e apartamentit, rezulton në vlerën 5247605,41 lekë. Në deklaratën periodike vjetore përkatëse, subjekti shprehet se ka pakësuar kursimet e akumuluar ndër vite vetëm në vlerën 2300000 lekë. Sipas kësaj deklarate, kursimet e subjektit në fund të vitit 2006, përfshirë edhe gjendjet e llogarive bankare, shkojnë në vlerën 2009776,62 lekë. Nga përlllogaritja e diferencës mes të ardhurave dhe kursimeve nga njëra anë, dhe shpenzimeve familjare, pasurisë së blerë dhe kursimeve të pretenduara, nga ana tjetër, rezulton se subjekti nuk ka arritur të vërtetojë me të ardhura të ligjshme krijimin e kësaj pasurie në vlerën 1985170,3 lekë.

10.1.7. Trupi gjykues i Kolegjit e konsideroi të pambështetur në fakte dhe në ligj të kryente hetim të vetin pranë autoriteteve tatimore, lidhur me subjektin “{***}” ShPK, si dhe pranë Autoritetit të Transportit Rrugor Elbasan, lidhur me mënyrën e ndryshimit të pronësisë së automjetit Mercedes Benz. Ky konkluzion u arrit, pasi nga analiza financiare dhe nga përlllogaritja e shtjelluar në paragrafin 10.1.3., kapaciteti financiar i provuar nga xhiroja dhe tatimet e paguara nga biznesi “farmaci” i personit të lidhur, nuk provon mundësinë teorike për të krijuar kapital të atillë sa të arrinte në shumën e pretenduar nga subjekti i rivlerësimit në seancën publike në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit. Ky konkluzion bazohet në parimet e kontabilitetit, të cilat rregullojnë transaksionet e shitjes-blerjes së mallrave, shërbimeve dhe veprimet me gjendjen e inventarit në fund dhe fillim të secilit vit kontabël, duke krijuar në fund të vitit një pasqyrë financiare të saktë mbi fitimin ose humbjen e njësisë së biznesit. Në vitet në të cilat ka operuar (1999-2003) prezumohet se farmacia është administruar mbi bazën e parashikimit të një xhiroje në fillim të çdo viti, parashikim i cili duhet të ketë shërbyer si bazë e vlerësimit të sasisë së nevojshme të mallrave për secilin vit. Duke ndjekur këtë logjikë të thjeshtë, gjendja e pretenduar e mallit të mbetur në fund të aktivitetit farmaci, duket se bie ndesh me parashikimin e xhiros së mundshme. Duke vlerësuar këto fakte, kundrejt fashës financiare së cilës i korrespondonte xhiroja vjetore e biznesit në fjalë, trupi gjykues në analizë të dokumenteve në fashikull, legjislacionit tatimor në fuqi në kohën në fjalë dhe pretendimeve të subjektit për këtë shkak ankimi, duke pasur parasysh që blerjes së mallit që pretendohet të ketë qenë gjendje në fund të vitit, i ka korresponduar një kosto fillestare e cila ka ndikuar në xhiron dhe fitimin e viteve paraardhëse, kjo vlerë e inventarit të mbetur nuk mund të përkthehet në një fitim neto në momentin e likuidimit, sikurse pretendohet.

10.1.8. Pas kërkesës së kryer nga subjekti i rivlerësimit dhe të pranuar nga trupi gjykues për t’i dhënë kohë²³ për të mbledhur dokumentet, trupi gjykues vëren që subjekti i rivlerësimit parashitroi se ishte në kushtet e nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016²⁴, pra të pamundësisë për të disponuar

²² Përbërë nga: shpenzimet e jetesës sipas standardit të INSTAT-it, të referuara nga ILDKPKI-ja, shpenzimet e udhëtimeve referuar nga të dhënat e sistemit TIMS dhe shpenzimet e mobilimit të deklaruara nga subjekti në pyetësorin e administruar nga Komisioni, me nr. {***} prot., datë 08.06.2018.

²³ Në seancën publike të datës 07.03.2019, subjektit iu dha kohë deri më datë 20.03.2019 për të paraqitur dokumentet.

²⁴ Neni 32, pika 2 parashikon: “[...] 2. Nëse subjekti i rivlerësimit është në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive, duhet t’i vërtetojë institucionit të rivlerësimit se dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk merret në rrugë tjetër. Institucionet e rivlerësimit vendosin nëse mosparaqitja e dokumenteve justifikuese është për shkak të arsyeshme. [...]”

dokumentacion për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar nga likuidimi i biznesit (2003) dhe kufizimeve që vendos ligji për DRTM-në, për t’iu dhënë informacion palëve të treta. Subjekti gjithsesi nuk arriti të provonte edhe pas kohës së dhënë nga Kolegji se mosparaqitja e dokumenteve justifikuese është për shkaqe të arsyeshme²⁵. Trupi gjykues rrjedhimisht vëren që edhe duke lënë mënjanë argumentin e provuar nga analiza financiare e kryer në Kolegji, përkundër fashës së tatimeve të paguara dhe xhiros së deklaruar ndër vite, përjashton mundësinë teorike të subjektit dhe personit të lidhur për të fituar në momentin e likuidimit të biznesit “farmaci” rreth 2.000.000 lekë. Rezulton se në harkun kohor nga gushti 2018 (kur është ankimuar vendimi nr. 47 i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, datë 25.07.2018, që konfirmoi në detyrë subjektin e rivlerësimit) deri në seancën e parë publike në Kolegji, më datë 07.03.2019, subjekti i rivlerësimit nuk ka ndërmarrë hapa seriozë që të provonin pamundësisë e tij objektive për të disponuar dokumentin që provon ligjshmërinë e të ardhurave, pavarësisht nga detyrimi që i binte barrë, sipas pikës 1 të së njëjtës dispozitë²⁶. Për këtë arsye, ky pretendim i subjektit të rivlerësimit, i ngritur prej tij edhe në kërkesën me shkrim të datës 12.04.2019, nuk u pranua, sipas nenit 49, pika 6, germa “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016²⁷.

10.1.9. Komisioneri Publik pretendoi se ligjshmëria e të ardhurave të personit tjetër të lidhur, z. A.P, duhet të ishte hetuar referuar vitit 2000, kur është blerë apartamenti, shitja e të cilit ishte burim i huas prej 10.000 eurosh dhënë subjektit të rivlerësimit në vitin 2006. Trupi gjykues i Kolegjit, në shqyrtim të rrethanave faktike dhe dokumenteve në fashikull, si dhe duke pasur parasysh edhe dëshminë e personit tjetër të lidhur, A.P., gjatë hetimit administrativ në Komision²⁸, për të vlerësuar ligjshmërinë e burimit të të ardhurave të personit në fjalë, vendosi që të arsyetojë bazuar në të ardhurat e gjeneruara nga shitja, të cilat kanë shërbyer si burim për huan subjektit të rivlerësimit. Në këtë kontekst, trupi gjykues vëren se personi tjetër i lidhur dhe bashkëshortja duket të kenë shitur apartamentin e ndodhur në rr. “{***}” në vitin 2006, në vlerën 5.900.000 lekë. Subjekti i rivlerësimit ka vepruar në emër të dy bashkëshortëve, në bazë të prokurës së posaçme lëshuar atij për këtë qëllim, më 11.12.2006²⁹. Si rrjedhojë, duke pasur parasysh dokumentet shkresore më sipër dhe prapësimet e subjektit të rivlerësimit mbi aftësinë huadhënëse dhe ligjshmërinë e të ardhurave nga shitja e apartamentit dhe dokumentet e tjera të sjella me vlerë provuese, si ato që provojnë vendqëndrimin dhe punësimin e personit tjetër të lidhur në Zvicër apo

²⁵ Neni 32, pika 2, parashikon: “Institucionet e rivlerësimit vendosin nëse mosparaqitja e dokumenteve justifikuese është për shkaqe të arsyeshme. [...]”.

²⁶ Neni 32, pika 1, parashikon: “[...] 1. Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, së bashku me deklaratën e pasurisë, paraqesin të gjitha dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive. [...]”.

²⁷ Neni 49, pika 5, germa “b”, parashikon: “[...] 6. Kërkesa për marrjen e një prove refuzohet nga Komisioni ose Kolegji i Apelit, nëse nuk lejohet nga ligji ose në rastet kur: [...] a) marrja e provës duket se është e panevojshme; b) fakti që kërkohet të provohet është i parëndësishëm për vendimmarrjen ose mund të rezultojë i provuar gjatë gjykimit [...]”.

²⁸ Datë 11.06.2018 (shih faqe 24 të vendimit të Komisionit).

²⁹ Shih fashikullin nr. 7 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, faqja 997. Prokurë e Posaçme hartuar përpara noterit Artan Treska, nr. {***} rep., nr. {***} kol.

karrierën e tij profesionale të suksesshme, trupi gjykues çmon se aftësia huadhënëse e shtetasit A.P. në vlerën 10.000 euro, siç kërkohet nga neni 32, pika 4³⁰ e ligjit nr. 84/2016, është e provuar.

10.1.10. Rezulton se shitja e apartamentit të shtetasit A.P. nga subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e përfaqësuesit të shitësit me prokurë, është bërë 7 ditë pasi subjekti i rivlerësimit e kishte paguar çmimin e plotë të shtëpisë së ndodhur në rr. “{***}”, Tiranë. Me fjalë të tjera, subjekti i rivlerësimit rezulton t'i ketë shlyer të gjitha pagesat, përfshirë edhe këstin e tretë të datës 05.12.2006 për blerjen e apartamentit në rr. “{***}” Tiranë, në vlerën 7.300 euro, pa iu nevojitur huaja nga {***}. Në shpjegim të kësaj mospërputhjeje kohore, në përgjigje të pyetësorit të Komisionit, subjekti i rivlerësimit deklaroi se huaja është përdorur për shpenzime mobilimi në vlerën 850.000 lekë dhe janë ruajtur rreth 400.000 lekë kursime nga huaja.

10.1.11. Lidhur me pretendimin e Komisionerit Publik mbi mungesën e një kontrate noteriale që do të vërtetonte ligjërisht shitjen e automjetit nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se në dosjen e gjykimit nuk ekziston një kontratë (noteriale ose në formë tjetër) për shitjen e këtij automjeti. Për më tepër, nga ana e Komisionit nuk është kryer hetim lidhur me këtë pasuri. Po ashtu, subjektit nuk i është kaluar barrë prove për të vërtetuar përfitimin e shumës përkatëse nga shitja e automjetit dhe nuk i është kërkuar Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor për vënien në dispozicion të praktikës së këtij automjeti. Gjetjet e trupit gjykues të Kolegjit, të shtjelluara më sipër (shih paragrafin 10.1.3.) në lidhje me pretendimet e subjektit për fitimet nga shitja e biznesit “farmaci”, vlejné edhe për këtë pronë. Subjekti nuk provoi me dokumentacion këtë pretendim, me gjithë kohën në dispozicion, nga data 28.08.2018 deri më datë 20.03.2019, kjo e fundit datë që përfshin edhe kohën shtesë të dhënë nga trupi gjykues i Kolegjit, pas kërkesës së bërë nga subjekti për kohë shtesë në seancën publike të datës 07.03.2019.

11. Në përfundim të sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pamjaftueshëm parashikuar nga pika 3 e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, si dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e pasurisë “apartament banimi”, me sipërfaqe 83,31 m², me adresë rr. “{***}”, Tiranë, sipas nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës.
12. Për pasurinë “truall + ndërtesë trekatëshe, me sipërfaqe 32 m² (32 m² + 32 m² + 48 m²)”, në qytetin e Librazhdit, me vlerë 2.786.720 lekë, trupi gjykues i Kolegjit mori në shqyrtim aktet si vijojnë:
 - i) kontratë shitblerjeje, nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 30.07.2003, për blerjen e truallit me sipërfaqe 32 m², në vlerën 150.000 lekë;
 - ii) certifikatë pronësie, nr. {***}, harta treguese për asetin truall me sipërfaqe 32 m² në emër të Astrit Faqollit;
 - iii) kontratë sipërmarrjeje, nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 30.03.2011, me shoqërinë

³⁰ Neni 32, pika 4, parashikon: “[...] 4. Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive. [...]”.

- “{***}” ShPK, për ndërtimin e objektit godinë banimi dhe shërbimi me sipërfaqe 30 m² kati dhe sipërfaqe totale 100 m², si dhe praktika bashkëlidhur;
- iv) shkresë nr. {***} prot., datë 25.10.2016, e Bashkisë Librazhd - kthim përgjigjeje drejtuar subjektit të rivlerësimit, ku i dërgohen kopje të dokumentacionit të kërkuar me shkresën nr. {***} prot., datë 21.10.2016;
 - v) faturë tatimore nr. {***}, datë 30.07.2011, në vlerën 2351937 lekë;
 - vi) faturë tatimore nr. {***}, datë 30.10.2011, në vlerën 434924 lekë;
 - vii) mandat arkëtimi nr. {***}, datë 03.09.2011, i cili konfirmon shumën 2352000 lekë, të arkëtuar nga subjekti i rivlerësimit për llogari të shoqërisë “{***}” ShPK;
 - viii) Mandat arkëtimi nr. {***}, datë 24.12.2011, i cili konfirmon shumën 435.000 lekë, të arkëtuar nga subjekti i rivlerësimit për llogari të shoqërisë “{***}” ShPK;
 - ix) situacion punimesh progresiv;
 - x) shkresa nr. {***} prot., datë 06.07.2017, e ZVRPP-së Librazhd, përcjellë me shkresën nr. {***} prot., datë 28.07.2017, të ZQRPP-së;
 - xi) deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.03.2012, dhënë nga shtetasi L.Sh. R, i cili ka deklaruar se në muajin gusht 2011 i ka dhënë hua subjektit të rivlerësimit shumën 1000000 lekë, pa afat dhe pa interes, që subjekti i rivlerësimit ta përdorte për ndërtimin e objektit trekatësh në qytetin e Librazhdit;
 - xii) deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 24.10.2016, nëpërmjet së cilës huadhënësi L.Rr. ka deklaruar se subjekti i rivlerësimit e ka kthyer shumën e huas së marrë;
 - xiii) dy vërtetime debie lëshuar më datë 05.06.2018 nga Drejtoria Rajonale e OShEE-së Elbasan;
 - xiv) ekstraktet e regjistrit elektronik të OShEE sh.a.;
 - xv) deklaratë noteriale nr. {***} rep., datë 14.02.2015;
 - xvi) deklaratë noteriale nr. {***} rep., datë 14.02.2015;
 - xvii) deklaratë noteriale nr. {***} rep., datë 21.01.2015;
 - xviii) kontratë qiraje lokali nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 05.02.2016;
 - xix) kontratë qiraje lokali nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 09.02.2016;
 - xx) kontratë qiraje apartamenti nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 10.02.2016;
 - xxi) shkresë nr. {***} prot., datë 12.01.2018, e ZVRPP-së Librazhd, e cila informon se në emër të shtetasit Astrit Faqolli rezulton e regjistruar pasuria me nr. {***}, vol. {***}, f. {***}, ZK {***}, ndodhur në Librazhd, e llojit truall, me sipërfaqe trualli 32 m² dhe

- sipërfaqe ndërtese 32 m², 3 kate (bodrum 1 kat + lokal 1 kat + banesë 1 kat);
- xxii) shkresë nr. {***} prot., datë 04.04.2018 e OShEE, e cila nuk ka konfirmuar kontratë furnizimi për lidhje me energji elektrike për këtë pasuri;
 - xxiii) shkresë nr. {***} prot., datë 11.04.2018, e Sh.A. Ujësjellës - Kanalizime Librazhd, ku konfirmohet se subjekti i rivlerësimit është abonent familjar dhe privat, me kontratën {***} dhe kod sistemi {***}, datë 27.07.2011, dhe se nuk ka detyrime pranë kësaj shoqërie;
 - xxiv) vërtetim nr. {***} prot., datë 10.07. (viti nuk lexohet) i Bashkisë Librazhd, që vërteton pagesën në shumën 90285 lekë, si taksë për ndërtim në infrastrukturë, në funksion të ndërtimit të objektit. Ky vërtetim i referohet mandatpagesës nr. {***}, datë 15.04.2011;
 - xxv) vërtetim nr. {***} prot., datë 10.07.2018, i Bashkisë Librazhd, që vërteton pagesën në shumën 30095 lekë, për studimin urbanistik në fund të ndërtimit të objektit. Ky vërtetim i referohet mandatpagesës nr. {***}, datë 15.04.2011;
 - xxvi) vërtetim nr. {***} prot., datë 10. (muaji dhe viti nuk lexohen) i Bashkisë Librazhd, që vërteton pagesën në shumën 9.600 lekë, për pajisjen me leje shfrytëzimi të objektit, sipas lejes së ndërtimit nr. {***}, datë (nuk lexohet). Ky vërtetim i referohet mandatpagesës nr. {***}, datë 09.12.2011;
 - xxvii) kontratë për shërbime ujësjellës-kanalizime nr. {***}, datë 27.07.2011, shoqëruar nga mandatarkëtimi datë 27.07.2011, në shumën 12.300 lekë dhe mandatarkëtimi datë 27.07.2011, në shumën 12.000 lekë. Në total, pagesa për shërbimet ujësjellës-kanalizime shkon në shumën 24.300 lekë;
 - xxviii) mandat arkëtimi nr. {***}, datë 12.09.2011, në shumën 18.240 lekë, me përshkrimin “Lidhje e re”, bërë nga Astrit Faqolli për “CEZ Shpërndarje” (sot OShEE);
 - xxix) mandat arkëtimi nr. {***}, datë 12.09.2011, në shumën 24.240 lekë, me përshkrimin “Lidhje e re”, bërë nga Astrit Faqolli për “CEZ Shpërndarje” (sot OShEE);
 - xxx) shkresë nr. {***} prot., datë 16.01.2018, e ZVRPP-së Tiranë, e cila informon mbi pasuritë e paluajtshme në emër të shtetasit L.Rr.;
 - xxxi) shkresë nr. {***} prot., datë 12.01.2018, e ZVRPP-së Librazhd, e cila informon se në emër të L.Sh.Rr., rezulton e regjistruar pasuria nr. {***}, vol. {***}, f. 10{***} ZK {***}, e llojit arë + truall, me sipërfaqe 600 m², ndodhur në Babje;
 - xxxii) shkresë nr. {***} prot., datë 18.04.2018 e QKB-së, e cila informon se shtetasi L.Sh.Rr. figuron i regjistruar me vendimin nr. {***}, datë 08.06.2005, të Gjykatës së Rrethit Tiranë, me NUIS (NIPT) {***}. Shtetasi L.Sh.Rr. figuron të jetë administrator dhe zotërues i 50% të kuotave në shoqërinë “{***}” ShPK, e regjistruar pranë QKB-së, më datë 17.08.2016, pajisur me NIPT {***};

- xxxiii) shkresë nr. {***}prot., datë 23.03.2018, e bankës “{***}”, e cila ka konfirmuar transaksione në llogarinë bankare të z. Rr., gjatë vitit 2009;
- xxxiv) shkresat nr. {***} prot., datë 23.02.2018, dhe nr. {***} prot., datë 12.03.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, të cilat informojnë se nga verifikimi i bërë në sistemin informatik të Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore të kësaj gjykate, nuk rezulton të ketë çështje penale ose civile të regjistruara në emër të shoqërisë “{***}” ShPK, regjistruar me emrin “{***}” ShPK, të shoqërisë “{***}” ShPK, z. L.Sh.Rr. dhe z. E.K.B. Njëkohësisht, edhe nga kërkimi në arkivin e gjykatës, nuk ekzistojnë të dhëna mbi kërkesëpadi, kërkesa civile apo penale, si dhe vendime të dhëna nga ish-Gjykata e Rrethit Gjyqësor Librazhd në emër të shoqërive apo këtyre shtetasve;
- xxxv) shkresë nr. {***} prot., datë 20.02.2018, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, e cila konfirmon se nuk ka të dhëna mbi kërkimin e Komisionit;
- xxxvi) shkresë nr. {***} prot., datë 27.02.2018, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila ka dërguar disa çështje apo vendime të dhëna për shoqëritë, sipas pikës xxxiv më sipër, si dhe z. B. me cilësinë e palës ndërgjyqëse, por në asnjë rast nuk rezulton që rastet të jenë gjykuar nga subjekti i rivlerësimit.

12.1. Komisioneri Publik pretendon se ka mospërputhje në deklaratimet e subjektit të rivlerësimit të viteve 2011 dhe 2017 (vetting), lidhur me vlerën e kësaj pasurie, deklaruar respektivisht 3.000.000 lekë në 2011-ën dhe 2.786.720 lekë në 2017-ën (deklarata vetting). Në analizë të këtij shkaku ankimi, trupi gjykues i Kolegjit vëren së pari se subjekti i rivlerësimit deklaroi sipas deklaratës së pasurisë (vetting) 2017 se vlera 2.786.720 lekë është vetëm pagesa e faturave për “{***}” ShPK. Sipas subjektit, vlera 3.000.000 lekë, e deklaruar në 2011-ën, përbëhet nga pagesa e faturave për “{***}” ShPK, si dhe pagesa e taksës në infrastrukturë në vlerën 90.285 lekë. Më tej, subjekti sjell në vëmendje se ka kryer pagesat që vijnë për këtë pasuri – në një total prej afërsisht 2.983.480 lekësh – vlerë e përafërt me vlerën e deklaruar 3.000.000 lekë, e konkretisht:

- 30.095 lekë, për studimin urbanistik në fund të ndërtimit të objektit;
- 9.600 lekë, për pajisjen me leje shfrytëzimi të objektit, sipas lejes së ndërtimit nr. 3;
- 24.300 lekë, pagesa për shërbimet ujësjellës-kanalizime;
- 18.240 lekë, për “Lidhjen e re”, nga “CEZ Shpërndarje” (sot OShEE) për Astrit Faqolli;
- 24.240 lekë, për “Lidhjen e re”, nga “CEZ Shpërndarje” (sot OShEE) për Astrit Faqolli.

12.2. Trupi gjykues i Kolegjit thekson se argumentimi i kësaj mospërputhjeje ndërmjet këtyre dy deklaratave në vlerën 213.280 lekë nga ana e Komisionit, është bërë në interpretim të gabuar të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Vlerësohet se nuk është i drejtë qëndrimi i Komisionit kur, në interpretim të pikës 2³¹ të kësaj dispozite, konkludon: [...] Kushtetuta e ka lidhur drejtpërdrejt

³¹ Neni D pika 2 e Aneksit të Kushtetutës parashikon: “[...]2. Subjekti i rivlerësimit dorëzon një deklaratë të re dhe të detajuar të pasurisë në përputhje me ligjin. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave kontrollon deklaratën e pasurisë dhe i dorëzon Komisionit një raport për ligjshmërinë e pasurive, për saktësinë dhe plotësinë e deklaratimit, sipas ligjit. [...]”.

përgjegjësinë e subjektit të rivlerësimit me Deklaratën e re të Pasurisë, dhe jo me deklaratimet e mëparshme të tij. Këto deklaratime mund të shërbejnë si provë për Komisionin në proces, por nuk mund të jenë shkak për shkarkimin e subjektit [...]. Trupi gjykues sjell në vëmendje se Kushtetuta nuk duket të ketë parashikuar nga ana formale apo nga një interpretim harmonik i dispozitave përkatëse në asnjë moment vlerën (primare) të deklaratës së pasurisë (vetting) 2017 apo të deklaratimeve të pasurisë në vite. Nga interpretimi sistematik i dispozitave kushtetuese rezulton se qëllimi i tyre nuk është të përcaktojnë rendin e rëndësisë së deklaratimeve. Verifikimi i saktësisë dhe plotësisë së deklaratimeve të subjektit, verifikimi i dyfishit të pasurisë, si dhe i burimeve të ligjshme të pasurisë, duke u dhënë të gjitha deklaratimeve vlerën e provës, përbëjnë në fakt kriteret në të cilat duhet të kalojë vlerësimi i pasurive të subjekteve të rivlerësimit, sipas nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

12.3. Sipas Komisionerit Publik, deklaratimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me burimin e kësaj pasurie janë kontradiktore. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në përgjigjet e pyetësorit të Komisionit se “[...] si burim për ndërtimin e objektit privat (Librazhd 2011) kanë shërbyer kursimet e krijuara në vitet para blerjes së banesës në Tiranë, të deklaruar më lart (viti 2006), si dhe kursimet nga vitet 2007, 2008, 2009 e 2010.” Gjithashtu, sipas subjektit, për krijimin e kësaj pasurie “kanë shërbyer edhe të ardhurat e realizuara në vitin 2011, si dhe huaja e marrë në bazë të deklaratës noteriale nga shtetasi L.Rr.”³² Trupi gjykues çmon se ky deklaram është kontradiktor me deklaratime të tjera të subjektit gjatë procesit të rivlerësimit, sipas të cilave: “Për blerjen e apartamentit në shumën totale 42.300 euro, e konvertuar sipas kursit të kohës rreth 5.250.000 lekë, është përdorur e gjithë gjendja *cash* që kam pasur në banesë nga kursimet e deklaruara në vitet 2003, 2004, 2005 në shumën totale 5.180.000 lekë.” Më tej vazhdon se: “Në deklaratën e interesave private periodikë vjetorë 2006, kam deklaruar të përdorur nga gjendja *cash*, e akumuluar në vitet 2003, 2004, 2005 për blerje shtëpie banimi, shumën 2.300.000 lekë. Mënyra e të shprehurit në deklaratën e interesave private periodikë vjetorë 2006 nuk ka qenë e duhura dhe jo e saktë, pasi, si dhe sqarova më sipër, vlera e apartamentit është likuiduar e gjitha brenda vitit 2006 dhe për këtë është përdorur e gjitha gjendja *cash* në shumën 5.180.000 lekë.”³³ Sikurse konstatohet, nga njëra anë subjekti deklaroi se për blerjen e pasurisë në 2006-ën në Tiranë ka përdorur të gjithë gjendjen *cash* në shumën 5.180.000 lekë, të akumuluar në vitet 2003, 2004 dhe 2005, ndërsa, nga ana tjetër, deklaroi se të njëjtat burime, kursimet para blerjes së shtëpisë në Tiranë (viti 2006) dhe nga të ardhura të tjera, kanë shërbyer për të mbështetur financiarisht krijimin e pasurisë së dytë në vitin 2011, në Librazhd. Për këto arsye, trupi gjykues vëren se subjekti ka qenë kontradiktor dhe i pasaktë lidhur me burimin e krijimit të pasurisë së dytë (truall + ndërtesë trekatëshe, me sipërfaqe 32 m² (32 m² + 32 m² + 48 m²), në qytetin e Librazhdit.

12.4. Lidhur me pretendimin e Komisionerit Publik se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për mbulimin e shpenzimeve dhe kursimeve të deklaruara si burim për

³² Shih përgjigjet e pyetësorit të administruar në fashikullin 7, faqe 977 të Komisionit.

³³ Shih përgjigjet e pyetësorit të administruar nga Komisioni me nr. {***} prot., datë 18.06.2018, në fashikullin 7, faqe 1064.

krijimin e kësaj pasurie, trupi gjykues i Kolegjit, nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, ka kryer analizën financiare. Si rezultat i kësaj analize, rezulton se gjendja financiare e mundshme e kursimeve të viteve më parë, në fillim të vitit 2011 është 1.010.026,46 lekë. Kjo vlerë përftohet nga shuma e kursimeve të mundshme të subjektit për vitet 2007, 2008, 2009, 2010. Të ardhurat për vitin 2011 janë në vlerën 1.442.440 lekë (përbërë nga të ardhurat e subjektit nga paga dhe të ardhurat e bashkëshortes në kompaninë {***} ShPK). Shpenzimet familjare të subjektit për këtë vit përlllogariten në vlerën 887.504,27 lekë³⁴. Vlera e pasurisë së shtuar në këtë vit, është 2.983.619 lekë. Gjendja e likuiditeteve në fund të periudhës është 118.100,3 lekë. Nga diferenca mes, nga njëra anë e të ardhurave, plus kursimet e viteve të mëparshme (1.010.026,46 lekë + 1.442.440 lekë) dhe, nga ana tjetër, e shpenzimeve familjare të subjektit, plus gjendjen e likuiditeteve në fund të vitit dhe vlerën e pasurisë së blerë (887.504,27 lekë + 118.100,3 lekë + 2.983.619 lekë), rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë në vlerën 1.536.757,12 lekë.

12.5. Komisioneri Publik parashtron se subjekti i rivlerësimit duhet ta deklaronte z. L.Rr. si person tjetër të lidhur, në përputhje me parashikimin e nenit 3, pika 14 e ligjit nr. 84/2016. Trupi gjykues i Kolegjit konstaton se ky pretendim i Komisionerit Publik është i drejtë. Subjekti i rivlerësimit nuk rezulton të ketë plotësuar në mënyrë të saktë dhe të plotë dhe në përputhje me kërkesat e nenit 3, pika 14 e ligjit nr. 84/2016 dhe me rregullat e udhëzimit nr. 4095 të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së³⁵, datë 10.10.2016, rubrikën “Të dhëna konfidenciale”, të deklaratës së pasurisë (*vetting*) 2017, të dhënat për z. L.Rr., lidhjen e këtij të fundit me subjektin e rivlerësimit, si dhe llojin e interesave privatë dhe vendndodhjen e tyre. Trupi gjykues çmon se pretendimi i subjektit të rivlerësimit se në momentin e plotësimit të deklaratës së pasurisë (*vetting*) 2017, huaja e z. Rr. ishte shlyer dhe, për pasojë, nuk ishte nevoja të deklarohet kjo hua, nuk qëndron. Sikurse është trajtuar edhe në pikën 10.1.1. të këtij vendimi, referuar legjislacionit të posaçëm të procesit të rivlerësimit dhe rregullave të detajuara të mënyrës së plotësimit të deklaratës së pasurisë *vetting*³⁶, subjekti i rivlerësimit kishte detyrimin të plotësonte të dhënat për çdo pasuri në pronësi, burimin në momentin e krijimit, duke bashkëlidhur dokumentacionin ligjor për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit për secilën pasuri në momentin e fitimit të tij. Arsyetimi i shtjelluar në paragrafin 10.1.1. më sipër, lidhur me qartësinë e udhëzimeve të deklaratës së pasurisë, gjen zbatim edhe në këtë rast. Më konkretisht, në deklaratën e pasurisë *vetting*, burimet e krijimit të pasurisë janë objekt shprehimisht i përfshirë ndër detyrimet e subjekteve, si dhe pjesë e trajtuar në mënyrë të shprehur në përshkrimin e atyre pasurive. Për rrjedhojë, ky pretendim i Komisionerit Publik është i drejtë. Trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit ka qenë kontradiktor në deklarimin e burimit të kësaj pasurie, referuar deklaratës periodike vjetore të pasurisë të vitit 2006 dhe

³⁴ Përbërë nga shpenzimet e jetesës sipas standardit të INSTAT-it, referuar nga ILDKPKI-ja, shpenzimet e udhëtimeve, referuar nga të dhënat e sistemit TIMS, dhe shpenzimet e mobilimit të deklaruara nga subjekti në pyetësorin e administruar nga Komisioni nr. {***} prot., datë 27.12.2017.

³⁵ Pika 6 e udhëzimit nr. 4095, datë 10.10.2016, parashikon: “Persona të tjerë të lidhur, në kuptim të ligjit nr. 84/2016, [...], që duket se kanë ose kanë pasur lidhje interesi me subjektin e rivlerësimit [...] që rrjedh nga një interes pasuror ose çdo marrëdhënie tjetër biznesi. Kur subjekti i rivlerësimit deklaron këto lloj marrëdhëniesh juridike me persona të tjerë të lidhur, ai mbart detyrimin të paraqesë dokumentacionin justifikues ligjor, në momentin e dorëzimit të deklaratës së pasurisë, për pronësinë dhe burimin e krijimit të pronës, që bëhet objekt i kësaj marrëdhënieje me subjektin e rivlerësimit”

³⁶ Shih pikat 7, 15, 18 dhe 22 të udhëzimit nr. 4095/2016 të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së.

deklaratës së pasurisë (*vetting*) 2017. Për këtë arsye, trupi gjykues konstaton se subjekti ka kryer deklarin të pasaktë për burimin e krijimit të kësaj pasurie.

12.6. *Komisioneri publik pretendon se personi tjetër i lidhur, z. L.Rr., nuk ka pasur mundësi financiare për t'i dhënë huan 1.000.000 lekë* subjektit të rivlerësimit. Kjo është sidomos me rëndësi në periudhën kohore kur z. Rr. deklarohet të ketë dhënë huan – gusht 2011 – që përkon me kohën kur ai investoi në pasuri të paluajtshme në vlerën përreth 6,2 milionë lekë. Së pari, trupi gjykues i Kolegjit vëren se nga ana e Komisionit nuk është kryer hetim i plotë dhe i gjithanshëm lidhur me mundësinë huadhënëse të [personit tjetër të lidhur] z. L.Rr. Komisioni duket të jetë mjaftuar me 3 (tri) tërheqje vlerash nga llogaria si person fizik prej z. L.Rr., e konkretisht, 1.000.000 lekë, 1.000.000 lekë dhe 500.000 lekë në vitin 2009, për të përcaktuar në këtë mënyrë aftësinë huadhënëse të personit tjetër të lidhur. Ndërkohë, pas shqyrtimit të akteve në fashikull, përfshirë edhe ato të sjella nga subjekti i rivlerësimit për efekt të provës, trupi gjykues vëren sa vijon:

12.6.1. Subjekti i rivlerësimit dhe personi tjetër i lidhur me deklaratë noteriale nr. {***} rep., {***} kol., datë 20.03.2012, disa muaj pas dhënies së huas së pretenduar, kanë deklaruar dhënien dhe marrjen e huas në muajin gusht 2011. Nga ana tjetër, trupi gjykues vëren se referuar shkresës nr. {***} prot., datë 26.10.2018, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, fitimi i realizuar për vitin 2009 i personit fizik L.Rr. është vetëm 31836 lekë, ndërsa në vitet pasardhëse 2010, 2011 dhe 2012 nuk janë dorëzuar deklaratat e të ardhurave dhe shpenzimeve. Duke pasur parasysh këto deklarime të vetë z. Rr., kundrejt legjislacionit tatimor të zbatueshëm për kohën, trupi gjykues vëren se pretendimi i subjektit të rivlerësimit nuk mund të pranohet. Nga dokumentet e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit në Kolegji, subjekti nuk arriti të vërtetojë me dokumentacion se z. L.Rr., ka pasur aftësinë huadhënëse me burime të ligjshme për vitin 2011 dhe vitet menjëherë përpara, pasi, sipas autoriteteve tatimore, ai ka deklaruar fitime minimale³⁷. Llogaritë bankare të paraqitura nga subjekti në seancën gjyqësore në Kolegji të datës 07.03.2019 rezultojnë të jenë llogari bankare të bashkëshortes së personit tjetër të lidhur dhe, për rrjedhojë, nuk mund të vërtetojnë nëse janë llogari të lidhura me aktivitetin e z. L.Rr.

12.6.2. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi dokumentacionin lidhur më punësimin e z. Rr. në vitet 2000, 2001, 2002, 2003, lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të të Siguruarve/Dega Rajonale 1 e Rrogëtarëve, nr. prot. {***}, datë 3/12/2018, Imathia, me seli Veria (Greqi), çmoi se vlera provuese e tyre është e kufizuar, për arsye se ato i referohen një periudhe kohore që daton shumë kohë përpara vitit 2011, kur është dhënë huaja. Dokumentacioni nuk përmbante elemente të formës, kërkuar nga ligji për dokumentacion, të lëshuara nga autoritetet zyrtare të vendeve të tjera.

12.6.3. Më tej, trupi gjykues i Kolegjit çmoi se në kushtet kur, sipas autoriteteve tatimore, biznesi i

³⁷ Pika 18 e udhëzimit nr. 4095/2016 parashikon: “Nëse subjekti i rivlerësimit deklaron marrëdhënie me persona të tjerë të lidhur (fizikë dhe juridikë) në cilësinë e [...] huadhënësit [...] detyrohet të paraqesë dokumentacionin justifikues ligjor, të lëshuar nga institucionet shtetërore dhe private për personat e tjerë të lidhur, referuar burimit të krijimit, të dhurimit, huadhënies dhe huamarrjes, dhënë subjektit të rivlerësimit”.

Pika 22 parashikon: “Deklarimi si burim krijimi pasurie i të ardhurave nga aktiviteti privat i subjektit të rivlerësimit dhe/ose personave të lidhur me të, të shoqërohet për periudhën e deklaruar me dokumentacionin justifikues ligjor nga zyrat e tatim taksave për fitimin e realizuar dhe dividendin e tërhequr.”

z. Rr. ka rezulton të ketë pasur xhiro minimale ose të papërfillshme në tri vitet që paraprijnë vitin 2011, në rrethanat konkrete të kësaj çështjeje dhe të kërkimeve të ngritura nga palët, një hetim lidhur me pasuritë e huadhënësit (z. Rr.) dhe shpenzimeve të jetesës së tij dhe familjarëve të tij do të kapërcente tagrat që ligji u njeh institucioneve në funksion të rivlerësimit. Për këto arsye, trupi gjykues vendosi të pranojë se subjekti i rivlerësimit nuk provoi me dokumentacion aftësinë huadhënëse me burime të ligjshme të z. Rr.

12.7. Komisioneri Publik pretendoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mundësi për të mbuluar me të ardhura të ligjshme pasurinë e krijuar në vitin 2011. Trupi gjykues i Kolegjit, në referim të analizës financiare të kryer, konstatoi se ky pretendim i Komisionerit Publik qëndron. Nga analiza në fjalë, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe shpenzimet për vitin 2011 në shumën prej 1.536.757,12 lekësh (shih pikën 12.4.)

12.8. Në përfundim të sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pamjaftueshëm, parashikuar nga pika 3 e nenit 61³⁸ të ligjit nr. 84/2016 dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie dhe deklaram të pasaktë, parashikuar nga neni D³⁹, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës.

- 13. Lidhur me pretendimin e Komisionerit Publik mbi deklaramet kontradiktore të subjektit të rivlerësimit për kursimet ndër vite të deklaruara në deklaramet periodike të pasurisë, trupi gjykues i Kolegjit konstatoi se kursimi i deklaruar në deklaramen periodike të pasurisë fillestare, të vitit 2003 në shumën 5.000.000 lekë, rezulton i pambështetur në burime të ligjshme për shumën prej 1.806.221 lekësh. Kursimi i deklaruar në vitin 2004, në shumën prej 1.000.000 lekësh, rezulton i pambështetur në burime të ligjshme për shumën 143.458 lekë, kurse kursimi i deklaruar në vitin 2005 në shumën 800.000 lekë rezulton i pambështetur në burime të ligjshme për shumën prej 542.895 lekësh. Për pasojë, pretendimi i Komisionerit Publik është i drejtë.*
- 14. Lidhur me pretendimin e Komisionerit Publik se subjekti i rivlerësimit nuk mbulon me të ardhura të ligjshme shlyerjet e deklaruara të detyrimeve (7.500 euro ndaj shtetasit A.P. dhe 1.000.000 lekë ndaj shtetasit L.Rr.) dhe shpenzimet vjetore për vitin 2016, trupi gjykues i Kolegjit konstatoi se nga verifikimi i deklaramave periodike të pasurisë të viteve 2011, 2012, 2013, 2014 dhe 2015*

³⁸ Neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 parashikon: “Shkarkimi nga detyra i subjektit të rivlerësimit jepet si masë disiplinore në këto raste: [...] 3. Kur rezulton se ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës dhe pasurisë, sipas parashikimeve të neneve 39 dhe 33 të këtij ligji. [...]”.

³⁹ Neni D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës parashikojnë respektivisht: “[...] 1. Subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen deklaramit dhe kontrollit të pasurive të tyre, me qëllim që të identifikohen ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht, ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur. [...]”

3. Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Elemente të tjera të pasurisë së ligjshme përcaktohen me ligj. [...]”

5. Nëse subjekti i rivlerësimit nuk e dorëzon deklaramen e pasurisë në kohë sipas ligjit, ai shkarkohet nga detyra. Nëse subjekti i rivlerësimit përpiqet të fshehtë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij, zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën.”

rezulton që subjekti i rivlerësimit ka deklaruar:

- në vitin 2011 - nuk ka kursime;
- në vitin 2012 - shtuar gjendja *cash* 200.000 lekë;
- në vitin 2013 - shtuar gjendja *cash* 200.000 lekë;
- në vitin 2014 - gjendja *cash* 300.000 lekë;
- në vitin 2015 - gjendja *cash* 400.000 lekë.

15. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se, nëse do të kryhej përlllogaritja në logjikën e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, sipas të cilit gjendja nënkupton shtimin dhe pakësimin pasurisë duke qenë se është deklaruar në rubrikën “Shtesa dhe pakësime”, në fund të vitit 2015, gjendja *cash* e subjektit të rivlerësimit do të ishte 1.100.000 në total. Kjo vlerë rezulton duke mbledhur të gjitha deklaratimet e subjektit si gjendje *cash* jashtë sistemit bankar, nga viti 2012 deri në vitin 2015, sipas vlerave të renditura më sipër, në pikën 14. Me fjalë të tjera, duke ndjekur logjikën e subjektit, pas shlyerjes së detyrimeve për blerje automjeti në vitin 2014, me burim krijimi nga kursimet e mëparshme, në vlerën 5.000 euro ose ekuivalenti 699.851 lekë (konvertuar me kursin mesatar të periudhës në vlerën 1 euro = 139,97 lekë, sipas publikimit të Bankës të Shqipërisë), subjekti i rivlerësimit do të kishte gjendje në formën e mbetjes në *cash*, një shumë prej 400.000 lekësh, e përbërë nga diferenca e kursimeve 1.100.000 lekë dhe e vlerës së makinës të blerë në vitin 2014 nga kursimet në vite, e cila rezulton e padeklaruar. Për këto arsye, rezulton se ka një pasaktësi në deklaram nga ana e subjektit. Nga analiza financiare në Kolegji, rezultoi se subjekti i rivlerësimit në fund të vitit 2015 nuk mund të kursente më shumë se 329.970,16 lekë⁴⁰. Ndërkohë që për vitin 2016, nga përlllogaritjet e kryera, rezultoi se të ardhurat e subjektit dhe të bashkëshortes të tij për këtë vit janë në vlerën 2.905.456 lekë⁴¹, shpenzimet e subjektit dhe të familjes të tij për këtë periudhë janë në vlerën 3.125.002,53 lekë⁴² dhe gjendja e llogarive bankare në datën 31.12.2016 është në vlerën 139.045,14 lekë. Nga diferenca e të ardhurave, plus kursimet e vitit të mëparshëm (2.905.456 lekë + 329.970,16 lekë) me shpenzimet e subjektit, plus gjendjen e likuiditeteve në fund të vitit (3.125.002,53 lekë + 139.045,14 lekë) rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka mundur të justifikojë shpenzimet me burime financiare të ligjshme në vlerën 28.621,51 lekë.
16. Nga ana tjetër, duke pasur parasysh që trupi gjykues vlerësoi se dokumentacioni në fashikull nuk vërteton aftësinë huadhënëse të z. L.Rr. me burime të ligjshme, përlllogaritja e të ardhurave të ligjshme për të paguar detyrimet e shlyera nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2016, nuk pasqyron

⁴⁰ *Vlera e likuiditeteve në llogaritë bankare të subjektit dhe e personave të lidhur, si dhe gjendja e mundshme e kursimeve cash në banesë në datën 31.12.2015.*

⁴¹ *Të ardhurat e subjektit dhe të bashkëshortes të tij nga paga, të ardhurat nga qiraja dhe të ardhurat nga shitja e automjetit në vitin 2016.*

⁴² *Përbërë nga shpenzimet e jetesës sipas standardit të INSTAT-it, referuar nga ILDKPKI-ja, shpenzimet e udhëtimeve referuar nga të dhënat e sistemit TIMS-it dhe shpenzimet e mobilimit të deklaruara nga subjekti në pyetësorin e administruar nga Komisioni, me nr. {***} prot., datë 27.12.2017, shpenzime shkollimi të fëmijëve të subjektit referuar vërtetimeve të shkollave përkatëse dhe gjithashtu shpenzimet e shlyerjes së huas, {***} A.P., në vlerën 7.500 euro.*

shumën e pretenduar hua nga z. Rr., pasi ky i fundit është konsideruar në pamundësi financiare me burime të ligjshme.

Në përfundim, të shqyrtimit të të gjitha shkaqeve të ankimit të ngritura nga Komisionerit Publik, vetëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe shpjegimet e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, bazuar në analizën dhe konkluzionet e mësipërme, trupi gjykues i Kolegjit, në mbështetje të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe të neneve 61 pika 3 dhe 66 pika 1, germa “b”, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, çmon se vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 47, datë 25.07.2018 duhet ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues bazuar në nenin D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, në nenin 61, pika 3, si dhe në nenin 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Ndryshimin e vendimit nr. 47, datë 25.07.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, duke vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Astrit Faqolli, gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë.
2. Ky vendim është përfundimtar, me efekt të menjëhershëm.

U shpall sot në Tiranë, më datë 18.04.2019.

GJYQTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

GJYQTAR

Luan DACI

nënshkrimi

GJYQTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

RELATORE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

KRYESUESE

Natasha MULAJ

nënshkrimi